BANKA E SHQIPËRISË

Revista Ekonomike

6M1-2022

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga: Banka e Shqipërisë,
Sheshi "Skënderbej", nr. 1, Tiranë, Shqipëri
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419409/10/11
Faks: + 355 4 2419408
E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

** Pikëpamjet e shprehura në këto artikuj janë të autorëve, punonjës të Bankës së Shqipërisë, dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të institucionit.*

P Ë R M B A J T J A

NJË KOMBINIM I QASJES MONETARE, FISKALE DHE STRUKTURORE NË MODELIMIN E INFLACIONIT NË SHQIPËRI *5*
Meri Papavangjeli, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë

NEVOJA PËR TË KONSIDERUAR MENAXHIMIN E RREZIKUT TË KLIMËS EDHE NGA BANKAT NË SHQIPËRI *21*
Lindita Molishti, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë

NJË KOMBINIM I QASJES MONETARE, FISKALE DHE STRUKTURORE NË MODELIMIN E INFLACIONIT NË SHQIPËRI

Meri Papavangjeli[1], *Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë*

ABSTRAKT

Në kontekstin aktual të pasigurive të larta në ekonominë globale dhe rritjes së çmimeve të mallrave në mbarë botën, ky artikull hulumton në mënyrë empirike faktorët përcaktues të inflacionit në Shqipëri, duke u përqendruar veçanërisht në zhvillimet në sektorin ushqimor në përgjithësi dhe atë të drithërave në veçanti, përgjatë periudhës 2000-2022. Duke marrë parasysh katër tregues të inflacionit: çmimet në sektorin e drithërave, ushqimeve, sektorin joushqimor dhe inflacionin total, artikulli analizon efektet e faktorëve vendas dhe të huaj, duke përdorur një model me vektorë të korrigjimit të gabimit (VECM), i cili lejon kapjen e efekteve afatshkurtra dhe afatgjata. Studimi merr në konsideratë edhe sektorin fiskal në shqyrtimin e dinamikave të inflacionit, i cili është neglizhuar deri tani në studimet aktuale mbi këtë temë. Analiza empirike konstaton se inflacioni i brendshëm përcaktohet nga disekuilibrat në sektorin monetar, atë të drithërave dhe sektorin joushqimor; në periudhën afatshkurtër, inflacioni nxitet nga faktorë strukturorë (veçanërisht hendeku i prodhimit bujqësor dhe inflacioni i importuar), si dhe faktorë nga ana e kërkesës (rritja e parasë dhe huamarrja e sektorit publik).

Fjalë kyçe: inflacion; faktorë monetarë, fiskalë dhe strukturorë

HYRJE

Në kontekstin aktual të pasigurive të larta në ekonominë globale, përfshirë këtu ndikimin e pandemisë COVID-19 dhe rreziqet gjeopolitike, çmimet globale të mallrave kanë qenë në rritje të vazhdueshme gjatë muajve të fundit dhe normat vjetore të inflacionit të çmimeve të konsumit kanë arritur nivelet e tyre më të larta ndër dekada, si në vendet e zhvilluara, ashtu dhe ato në zhvillim, duke tejkaluar pritshmëritë e shumë analistëve në mbarë botën. Zhvillime të tilla kanë intensifikuar debatin dhe kanë zhvendosur vëmendjen kolektive drejt të kuptuarit të mekanizmave që përcaktojnë dinamikat e inflacionit edhe në Shqipëri.

Artikulli hulumton në mënyrë empirike forcat përcaktuese të inflacionit në Shqipëri, bazuar në disa qasje, konkretisht atë monetare, fiskale dhe strukturaliste, duke u fokusuar në cenueshmërinë e vendit ndaj goditjeve që

[1] *e-mail: mpapavangjeli@bankofalbania.org. Pikëpamjet e shprehura në këtë artikull janë të autorit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.*
Falënderoj z. Ilir Vika, Përgjegjës i Sektorit të Modelimit Ekonomik, për komentet dhe sugjerimet e vlefshme.

ndikojnë sektorin bujqësor dhe ekspozimin ndaj goditjeve të jashtme, por duke përfshirë edhe faktorë të anës së kërkesës, si: treguesit monetarë dhe ata fiskalë. Inflacioni total ndahet në disa komponentë (drithëra, ushqime dhe produkte joushqimore), duke qenë se secili prej tyre mund të përcaktohet nga faktorë të ndryshëm.

Më pas vlerësohet një model me vektorë të korrigjimit të gabimit, i cili lejon kapjen e efekteve afatshkurtra dhe afatgjata (nëpërmjet rregullimit të ekuilibrit në sektorët përkatës) të forcave të brendshme dhe të jashtme që ndikojnë në inflacion. Gjetjet empirike tregojnë se inflacioni i brendshëm mbështetet nga disekuilibrat në sektorin monetar, sektorin e drithërave dhe atë joushqimor, ndërsa në periudhën afatshkurtër, inflacioni nxitet nga faktorë strukturorë (veçanërisht hendeku i prodhimit bujqësor dhe inflacioni i importuar), si dhe faktorë nga ana e kërkesës (veçanërisht rritja e parasë dhe huamarrja e sektorit publik).

QASJE PËR MODELIMIN E INFLACIONIT

Natyra e ndërlidhur e fenomeneve ekonomike e bën empirikisht të vështirë përcaktimin e burimeve të inflacionit (Ghatak, 1995; Thirlwall, 2003). Kështu, debati midis mbështetësve të qasjeve të ndryshme mbetet i pranishëm edhe në ditët e sotme, veçanërisht në kontekstin aktual të rritjes globale të çmimeve. Ky studim kombinon qasjet kryesore të modelimit të inflacionit, përkatësisht teorinë monetare, fiskale dhe teorinë "strukturaliste" të inflacionit, për të specifikuar modelet e vlerësimit që shpjegojnë kategoritë e ndryshme të inflacionit dhe për të thelluar më tej të kuptuarit e dinamikës së tyre.

Sipas qasjes monetare, inflacioni buron nga disekuilibrat në tregun e parasë, pra nga zgjerimi i tepërm i ofertës së parasë përcaktuar në mënyrë ekzogjene, në raport me kërkesën për bilance reale. Nga ana tjetër, teoria fiskale e inflacionit sugjeron se deficiti fiskal mund të ndikojë në nivelin e çmimeve nëpërmjet ndikimit të tij në kërkesën për para dhe në këtë mënyrë, edhe në ekuilibrin në tregun e parasë. Ajo e përshkruan inflacionin ekuilibër si funksion të deficitit fiskal ndaj raportit të stokut të parasë (Catão dhe Terrones, 2005; Gordon dhe Leeper, 2006).

Gjithashtu, ekziston edhe qasja strukturaliste e inflacionit të importuar, e cila pohon si më poshtë. Së pari, në kundërshtim me këndvështrimin monetarist, zgjerimi i tepërt monetar nga banka qendrore nuk konsiderohet si shkaktari i vetëm i inflacionit (Pinga dhe Nelson, 2001). Mbështetësit e pikëpamjes strukturaliste të inflacionit argumentojnë se stoku i parasë është "pjesërisht" endogjen dhe në disa situata luan vetëm një rol pasiv në procesin e inflacionit. Së dyti, kapitali i importuar dhe mallrat e ndërmjetme janë faktorë thelbësorë në procesin e prodhimit të vendeve në zhvillim (shih Taylor, 1983; Thirlwall, 1974). Së treti, aftësia e vendeve në zhvillim për të financuar mallrat e importuar kufizohet nga mungesa e valutës, për shkak të faktit se shumë nga këto vende eksportojnë vetëm disa mallra parësore (ose produkte intensive pune me nivel të ulët teknologjie) me elasticitet relativisht të ulët të të ardhurave

në tregjet ndërkombëtare, ndërkohë që kërkesa për importe ka elasticitet të lartë në lidhje me të ardhurat (Argy, 1970; Ghatak, 1995; Thirlwall, 1974). Inflacioni i brendshëm në Shqipëri "ushqehet" nga produktet ushqimore dhe energjetike të importuara, si dhe nga luhatjet e kursit të këmbimit, siç konfirmohet edhe nga disa studime të ngjashme empirike të bëra mbi këtë temë (Çeliku et al., 2019; Papavangjeli, 2019; Skufi, Kika, 2019; Skufi, Çela, 2017). Sjellja e sektorit bujqësor është një nxitës i rëndësishëm i inflacionit në Shqipëri. Sektori bujqësor kontribuon me rreth 20% në Produktin e Brendshëm Bruto (PBB), por megjithatë Shqipëria përmbush një pjesë të konsiderueshme të kërkesës së brendshme për drithëra e ushqime nëpërmjet importeve.

Ushqimet janë një komponent i rëndësishëm i shportës së konsumit për pjesën më të madhe të popullsisë, pesha përkatëse e të cilave është rreth 42% në shportën e konsumit; për rrjedhojë, lëvizjet në çmimet e ushqimeve përcaktojnë edhe dinamikën e inflacionit total. Gjithashtu, ekspozimi i prodhimit bujqësor ndaj goditjeve të motit mund të gjenerojë ndryshime të mëdha dhe të shpeshta në prodhim, e për pasojë edhe në çmime. Goditjet negative në prodhimin vendas të ushqimit mund të nxisin gjithashtu një rritje të importeve ushqimore, të cilat mund të përkeqësojnë dhe të zgjasin efektet e inflacionit të importuar në inflacionin e përgjithshëm.

Një kanal tjetër i presioneve të jashtme mbi çmimet e brendshme janë importet e naftës dhe produkteve të lidhura me to, të cilat përfaqësojnë rreth 16% të totalit të importeve të Shqipërisë. Kështu, vendi është i ekspozuar ndaj çmimeve ndërkombëtare të energjisë, të cilat kalojnë përmes kostove të prodhimit vendas të mallrave dhe shërbimeve, duke rritur inflacionin total. Kursi i këmbimit luan gjithashtu një rol të rëndësishëm në çdo ekonomi të varur nga importi, siç është rasti i Shqipërisë (siç tregohet edhe në disa studime mbi këtë temë (Tanku, Vika, 2020; Vika, Rama, 2017)). Një zhvlerësim i monedhës vendase rrit koston e importeve, e cila nga ana tjetër rrit çmimet e brendshme.

SPECIFIKIMI I MODELIT DHE PROCEDURA E VLERËSIMIT

Në këtë seksion, paraqitet një model empirik që përmbledh qasjet e ndryshme të inflacionit të përmendura më sipër dhe na lejon të testojmë hipoteza të ndryshme. Në linjë me Mawejje dhe Lwanga (2016), dhe me Durevall (2010), inflacioni shihet si një fenomen që buron ose nga rregullimi i çmimeve në tregjet me kërkesë apo ofertë të tepërt, ose nga rregullimi i çmimeve për shkak të kostove të importit. Qasja e modelimit e përdorur këtu merr parasysh disa karakteristika strukturore të ekonomisë shqiptare, të tilla si: (i) ekspozimi ndaj goditjeve bujqësore që ndikojnë në çmimet e ushqimeve dhe në nivelin e përgjithshëm të çmimeve; (ii) varësia nga importet dhe ekspozimi ndaj goditjeve të çmimeve ndërkombëtare, veçanërisht çmimeve të drithërave, ushqimeve dhe naftës; dhe (iii) represioni financiar që vjen nga financimi direkt dhe indirekt i deficitit fiskal.

Ekuilibri i tregut të parasë, në një ekonomi të hapur, e cila merr parasysh edhe rolin e kursit të këmbimit për vendimet e portofolit, mund të shprehet si më poshtë:

$$(m-p) - \lambda y + \rho r + \gamma e = 0 \qquad (1)$$

ku m, p, y, r dhe e janë ndryshimet vjetore në stokun e parasë, nivelin e çmimeve, prodhimit dhe normës së interesit, dhe y, p dhe e janë përkatësisht elasticitetet e kërkesës për para në lidhje me prodhimin, normën e interesit, dhe kursin e këmbimit.

Kërkesa për bilance reale ndikohet edhe nga kursi i këmbimit. Ndryshimet në kursin e këmbimit ndikojnë në kthimin e aseteve të huaja dhe rrjedhimisht kërkesën e tyre në raport me asetet vendase. Në mungesë të kontrolleve të këmbimit valutor, vlerësimi ose zhvlerësimi i pritshëm do të ndikojë në kërkesën për asete të huaja si zëvendësues të monedhës vendase.

Teoria fiskale e inflacionit sugjeron se deficiti fiskal mund të ndikojë në nivelin e çmimeve nëpërmjet ndikimit të tij në kërkesën për para dhe për pasojë, edhe në ekuilibrin e tregut të parasë. Në veçanti, huamarrja e qeverisë për financimin e deficitit rezulton në ekspansion monetar, i cili rrit inflacionin. Në përputhje me këtë teori, ekuilibri i dytë afatgjatë, i cili përshkruan një marrëdhënie midis inflacionit dhe raportit të deficitit fiskal dhe bilanceve reale të parasë, paraqitet si më poshtë:

$$\frac{M}{p} = \delta_1(G^{prim} - T) + \delta_2 \Delta pubdebt_t \qquad (2)$$

ku, koeficientët δ_1 dhe δ_2 përfaqësojnë efektet afatgjata të deficitit fiskal primar dhe borxhit publik në kerkesën për bilance reale.

Më tej, "ligji i një çmimi" ose pariteti i fuqisë blerëse zbatohet si për tregjet ushqimore, ashtu edhe ato joushqimore, sipas të cilit lidhjet ndërmjet nivelit të çmimeve dhe kursit të këmbimit në afatgjatë reflektohen në trendin e kursit real të këmbimit ose në termat e tregtisë së mallrave vendase kundrejt mallrave të huaj. Kushti i ekuilibrit mund të shprehet si:

$$e + p_f - p = 0 \qquad (3)$$

Këto marrëdhënie kointegrimi testohen e vlerësohen për disa artikuj të shportës së konsumit: të gjithë artikujt e shportës, vetëm artikujt ushqimorë, artikujt joushqimorë dhe drithërat gjithashtu, duke pasur parasysh peshën e tyre të konsiderueshme në prodhim, konsum dhe importe. Në vijim, ky studim konsideron hendekun e prodhimit bujqësor në vend të hendekut të përgjithshëm të PBB-së si një përcaktues të presioneve inflacioniste që vijnë nga kahu i ofertës.

Prodhimi potencial bujqësor llogaritet duke përdorur filtrin Hodrick-Prescott (HP) sipas formulës:

$$\min \sum_{t=0}^{T} (y_t - s_t)^2 + \lambda \sum_{t=2}^{T=1} ((s_{t+1} - s_t) - ((s_t - s_{t-1}))^2$$

ku λ është niveli i filtrimit të trendit (që supozohet $\lambda = 6400$), është komponentja e trendit të serisë së prodhimit bujqësor dhe y është prodhimi bujqësor aktual.

Metodat e modelimit ekonometrik të serive kohore përdoren për të vlerësuar katër modele për secilën nga matjet e inflacionit (drithërat, ushqimet, inflacioni joushqimor dhe inflacioni total) nëpërmjet një procedure me dy hapa. Hapi i parë vendos marrëdhënie afatgjata në sektorin monetar dhe fiskal, si dhe në sektorin ushqimor dhe joushqimor. Pas specifikimit dhe vlerësimit të marrëdhënies afatgjatë në secilin prej këtyre sektorëve, koeficientët e vektorit kointegrues përdoren për të llogaritur devijimet nga ekuilibri.

Në hapin e dytë të analizës empirike, vlerësohen disa modele ARDL (me vonesa autoregresive të shpërndara) me gabime standarde HAC (konsistent me heteroskedasticitet dhe autokorrelacion) për inflacionin e drithërave, ushqimeve, artikujt joushqimorë dhe artikujt e gjithë shportës së konsumit, duke përfshirë në specifikim edhe mbetjet e korrektimit të gabimit të vlerësuara në hapin e parë. Duke aplikuar metodologjinë nga e përgjithshmja në specifike, analiza fillon me modele të mbiparametizuara, ku variablat afatshkurtra kanë nga 4 vonesa secila dhe më pas, modele "më të kursyera" të inflacionit nxirren nëpërmjet një procesi të reduktimit të modelit.

Secili model i kategorizon përcaktuesit e inflacionit në: përcaktues afatgjatë, faktorë afatshkurtër të brendshëm dhe faktorë afatshkurtër të jashtëm. Përcaktuesit afatgjatë përfaqësohen nga vektorët kointegrues të nxjerrë në hapin e parë të analizës. Përcaktuesit afatshkurtër janë vonesat e diferencave të para të variablave të interesit. Më konkretisht, modeli përfshin marrëdhëniet afatgjata në sektorin monetar (ekuacioni 1), në sektorin fiskal (ekuacioni 2) dhe sektorët ushqimorë dhe joushqimorë (ekuacioni 3), si dhe efektet inerciale të çmimeve të brendshme, efektet afatshkurtra të hendekut të prodhimit bujqësor, rritjes së parasë, huamarrjes së sektorit publik dhe deficitit fiskal primar, kursit të këmbimit dhe çmimeve ndërkombëtare, si në specifikimet e mëposhtme.

Modeli bazë specifikohet si më poshtë:

$$\Delta p_t = \theta_0 + \sum_{j=2}^{k} \theta_{1j} \Delta p_{t-j} + \theta_2 agrigap + \sum_{j=2}^{k} \theta_{3j} \Delta m_{t-j} + \sum_{j=2}^{k} \theta_{4j} \Delta p^{w}_{cereals\ t-j} + \sum_{j=2}^{k} \theta_{5j} \Delta er_{t-j} + \theta_6 ECM_m + \theta_7 ECM_{cer} + \theta_8 ECM_{nfood} + \varepsilon_t \quad (4)$$

Sikurse u tha edhe më lart, modeli bazë vlerësohet për katër tregues të inflacionit *(Δp)*: drithërat *(cerp)*, ushqimet *(fp)*, artikujt joushqimorë *(nfp)* dhe inflacioni total *(Δp)*. Variabli *agrigap* përfaqëson hendekun e prodhimit bujqësor si një përcaktues i presioneve inflacioniste që rrjedhin nga oferta e brendshme ushqimore, *m* është stoku real i parasë, Δp^w është inflacioni (duke përfshirë çmimin e drithërave, çmimin e ushqimeve, çmimin e artikujve joushqimorë dhe ndryshimet e çmimit të karburanteve në tregun global, i futur në model sipas specifikimeve të ndryshme të modelit), ndërsa *er* është kursi i këmbimit të lekut me euro.

Termat e korrigjimit të gabimit (ECM) përfaqësojnë përkatësisht ekuacionet e kointegrimit (disekuilibri) për tregun e parasë, për sektorin e ushqimeve (drithërave) dhe tregjet joushqimore të vlerësuara në hapin e parë të procedurës. Për më tepër, në çdo ekuacion afatshkurtër, përfshihen disa variabla binarë që kapin "pikat e mprehta" në çmimet botërore të ushqimeve dhe drithërave, dhe në hendekun e prodhimit bujqësor që lidhen zakonisht me goditjet në prodhimin e ushqimeve, në mënyrë që të mund të shpjegohet edhe rritja e çmimeve të brendshme vërejtur gjatë periudhës së fundit.

Ekuacioni ECM për sektorin monetar është një version i modifikuar i ekuacionit (1) që përjashton normën e interesit dhe përfshin kursin real të këmbimit[2]:

$$(m-p) - \lambda y + \gamma e + c = 0 \qquad (5)$$

ku variablat përcaktohen si më lart dhe c është një konstante.

Ekuacionet përkatëse ECM për sektorin e ushqimeve dhe atë joushqimor përcaktohen si më poshtë:

$$e + p_f^w - p_f + c = 0 \qquad (5a)$$
$$e + p_{nf}^w - p_{nf} + c = 0 \qquad (5b)$$

Analiza empirike vijon me vlerësimin e një specifikimi alternativ që përfshin sektorin fiskal, bazuar në qasjen fiskale të inflacionit, përcaktuar si:

$$\Delta p_t = \theta_0 + \sum_{j=2}^{k} \theta_{1j} \Delta p_{t-j} + \theta_2 agrigap + \sum_{j=2}^{k} \theta_{3j} \Delta pub_{t-j} + \sum_{j=2}^{k} \theta_{4j} \Delta p^w_{cereals\ t-j} + \sum_{j=2}^{k} \theta_{5j} \Delta er_{t-j} + \theta_6 ECM_{fiscal} + \theta_7 ECM_{food} + \theta_8 ECM_{nfood} + \varepsilon_t \qquad (6)$$

ku pub përfaqëson huamarrjen e sektorit publik, dhe ECM_{fiscal} është gjeneruar nga marrëdhënia e ekuilibrit afatgjatë në sektorin fiskal, sikurse specifikohet në ekuacionin (2), duke përfshirë edhe një term konstant.

Modelet individuale për secilin prej sektorëve janë specifikuar në logaritme natyrore dhe të gjitha seritë rezultojnë të jenë të integruara të rendit të parë I(1), pasi testohen për stacionaritet përmes testit Phillips-Perron. Më tej, variablat e përfshirë në modelet afatshkurtra specifikohen në formë stacionare si norma vjetore ndryshimi ose si tregues relativë (shprehur në përqindje) ndaj një treguesi tjetër. Periudha e vlerësimit nis nga viti 2000, për shkak të cilësisë jo të mirë të të dhënave gjatë dekadës së parë të tranzicionit.

[2] *Zëvendësimi i normës së interesit me kursin e këmbimit është bërë për të mundësuar lidhjen me marrëdhëniet ekuilibër në dy tregjet e tjera sipas paritetit të fuqisë blerëse.*

PËRSHKRIMI I TË DHËNAVE DHE REZULTATET EMPIRIKE

Baza e të dhënave përfshin të dhëna tremujore që mbulojnë periudhën 2000T1-2022T1 për disa tregues ekonomikë: prodhimi real, hendeku i prodhimit bujqësor, niveli i çmimeve, kursi i këmbimit (ALL/EUR), agregatët monetarë dhe treguesit fiskalë si: bilanci fiskal primar dhe borxhi publik. Rritja reale e prodhimit përfaqësohet nga rritja vjetore e PBB-së me çmime konstante të shprehura në milionë lekë dhe niveli i çmimeve matet me disa indekse çmimesh: indeksin e drithërave, ushqimeve, artikujve joushqimorë dhe IÇK-së (Indeksi i Çmimeve të Konsumit). Rritja e ofertës monetare përfaqësohet nga rritja e agregatit monetar M3 e shprehur në terma realë, e deflatuar nga inflacioni i IÇK-së.

Të dhënat për treguesit e brendshëm janë marrë nga Instituti Kombëtar i Statistikave (INSTAT), Banka e Shqipërisë (BSH) dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), ndërsa të dhënat për çmimet ndërkombëtare janë marrë nga të dhënat e çmimeve të mallrave të Bankës Botërore. Një informacion më i detajuar mbi listën e variablave të përdorur në regresione jepet në tabelën A1 në shtojcë.

Tabela 1 përmbledh rezultatet e vlerësimit të specifikimit bazë, të cilat konfirmojnë se inflacioni në Shqipëri përcaktohet nga disa faktorë afatgjatë dhe afatshkurtër. Zhvillimet e sektorit monetar janë përcaktues të rëndësishëm afatgjatë të inflacionit në Shqipëri. Siç tregohet në ekuacionin e vlerësuar të kointegrimit (termi ECM për sektorin monetar), rritja e tepërt e ofertës monetare ka një ndikim afatgjatë pozitiv në nivelin e përgjithshëm të çmimeve, kur kontrollojmë për faktorët kryesorë të kërkesës për para, si PBB-ja dhe kursi i këmbimit (ku ky i fundit është një përafrim i kostos oportune të mbajtjes së likuiditetit në monedhën vendase). Më konkretisht, një rritje prej 1% e PBB-së rrit kërkesën për para me 0.8% dhe një rritje prej 1% e kursit real të këmbimit kontrakton kërkesën për para me 0.12% në periudhën afatgjatë. Disekuilibrat në sektorin monetar shkaktojnë presione inflacioniste në të gjithë treguesit e çmimeve: çmimet e drithërave, çmimet e ushqimeve, artikujve joushqimorë dhe çmimet e përgjithshme, por efekti është statistikisht i rëndësishëm vetëm për këto të fundit.

Tabela 1. Specifikimi bazë

Variablat		Drithëra	Ushqime	Artikuj joushqimorë	Inflacion total
		Efektet e axhustimit			
Sektori monetar	$[(m-p) -0.79y+0.12e]_{t-1}$	0.202 (0.106)	0.058 (0.869)	0.035 (0.974)	0.339* (0.091)
Sektori i drithërave	$[(e+ p_f^w)- 0.88p_f - 5.23]_{t-1}$	0.049*** (0.009)	0.051** (0.030)		0.410* (0.095)
Sektori joushqimor	$[(e+ p_{nf}^w) - 0.41p_{nf} -5.79]_{t-1}$			0.034** (0.015)	0.360* (0.079)
		Faktorë të brendshëm			
Inflacioni i brendshëm i drithërave (-1)		0.462*** (0.000)			0.031* (0.062)
Hendeku i prodhimit bujqësor (-1)		-0.133* (0.093)	-0.049* (0.061)		-0.003* (0.053)
Rritja e parasë(-1)		0.026 (0.814)	0.051 (0.874)	0.057 (0.208)	0.021* (0.096)
Inflacioni i brendshëm i ushqimeve(-1)			0.628*** (0.000)		
Inflacioni i brendshëm joushqimor (-1)				0.173* (0.052)	
		Faktorë të jashtëm			
Inflacioni botëror i drithërave		0.211** (0.027)			0.042** (0.024)
Inflacioni botëror i ushqimeve			0.241** (0.023)		
Inflacioni botëror joushqimor				0.003* (0.072)	
Kuris i këmbimit		0.001 (0.106)	0.005 (0.113)	0.017 (0.908)	0.029* (0.059)
Çmimi botëror i karburanteve					0.001 (0.109)
Inflacioni botëror i ushqimeve*dum		0.043** (0.016)	0.012** (0.034)		0.014* (0.074)
Konstante		0.002 (0.243)	0.004 (0.321)	0.002* (0.067)	0.135*** (0.000)
Obs.		73	73	73	73
R-katror e axhustuar		0.415	0.497	0.267	0.419

*Shënim: *** tregon rëndësinë statistikore në nivelin 1%, ** në 5% dhe * në 10%.*
Dum është një variabël binar që kap "pikat e mprehta" në çmimet botërore të ushqimeve.

Në periudhën afatgjatë, çmimet ndërkombëtare të ushqimeve kanë një efekt të rëndësishëm edhe në çmimet e brendshme të drithërave dhe ushqimeve, edhe në inflacionin e përgjithshëm: duke mbajtur konstant kursin e këmbimit, një rritje prej 1% e çmimit të ushqimeve në tregjet ndërkombëtare rrit çmimet e brendshme të drithërave me rreth 0.9%, duke treguar se Shqipëria është e integruar në tregjet ndërkombëtare ushqimore dhe është e varur nga importet ushqimore. Gjithashtu, çmimet e artikujve joushqimorë në Shqipëri përcaktohen nga çmimet botërore në terma afatgjatë dhe më konkretisht: një rritje prej 1% e indeksit ndërkombëtar të çmimeve joushqimore rrit me 0.4% çmimet vendase të artikujve joushqimore.

Për sa i përket periudhës afatshkurtër, inflacioni nxitet kryesisht nga faktorë strukturorë: inflacioni sporadik i çmimeve të ushqimeve duket se ndikohet më shumë nga çmimet ndërkombëtare dhe hendeku i prodhimit bujqësor sesa rritja e parasë dhe kursit të këmbimit. Rritja e parasë ndikon pozitivisht në të gjithë treguesit e çmimeve, por efekti është statistikisht i rëndësishëm vetëm për inflacionin total. Një çështje e rëndësishme në vlerësimin e ndikimit të rritjes së parasë në inflacion është se efekti i saj mund të kompensohet ose të përforcohet nga ndryshimet në kursin e këmbimit ose kërkesën agregate. Hendeku i prodhimit bujqësor ka një ndikim negativ dhe statistikisht të rëndësishëm në inflacionin e drithërave, inflacionin e ushqimeve dhe inflacionin total, gjë që nënkupton që një goditje negative në ofertën e brendshme të ushqimeve shoqërohet me presione inflacioniste në tregues të caktuar të inflacionit. Siç pritej, ndikimi i hendekut të prodhimit është më i fortë në çmimet e drithërave krahasuar me treguesit e tjerë. Çmimet ndërkombëtare janë një përcaktues tjetër shumë i rëndësishëm i çmimeve të brendshme, dhe efekti i tyre përforcohet veçanërisht gjatë periudhave të rritjeve të mprehta të çmimeve në nivel global, sikurse ato që po përjetojmë aktualisht. Megjithatë, një analizë e plotë me të dhëna mujore mund të zbulojë më shumë mbi këtë çështje.

Vlen të theksohet reagimi më i dobët i çmimeve të artikujve joushqimorë ndaj faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë në treguesit e tjerë të inflacionit, i cili mund të shpjegohet me faktin se kjo kategori përfshin disa mallra me çmime të kontrolluara dhe shpesh të vendosura drejtpërdrejt nga qeveria, siç është karburanti. Inflacioni i drithërave dhe ai i ushqimeve shfaqin një persistencë të lartë, ku ndryshimet e kaluara në çmimet e brendshme çojnë në inflacion të lartë në periudhën aktuale.

Gjithashtu, për secilin nga treguesit e inflacionit vlerësohen specifikime alternative, duke zëvendësuar treguesit monetarë me ata fiskalë në marrëdhëniet afatshkurtra, për të studiuar implikimet inflacioniste të treguesve fiskalë. Një rritje prej 1% e deficitit rrit stokun e parasë reale me 2.2% dhe një rritje prej 1% e borxhit të sektorit publik rrit stokun e parasë reale me 0.68%, por efekti i disekuilibrit në sektorin fiskal në inflacion në periudhën afatgjatë nuk është i rëndësishëm.

Tabela 2. Specifikim alternativ që përfshin sektorin fiskal

Variablat		Drithëra	Ushqime	Artikuj joushqimorë	Inflacion total
		Efektet e axhustimit			
Sektori fiskal	$[(m-p) - 2.23*pubdef - 0.68*debt]_{t-1}$	-0.096 (0.363)	-0.066 (0.869)	0.072 (0.454)	-0.009* (0.091)
Sektori i drithërave	$[(e+ p^{w}_{f}) - 0.88p_{f} -5.23]_{t-1}$	0.049*** (0.009)	0.051** (0.030)		0.410* (0.095)
Sektori joushqimor	$[(e+ p^{w}_{nf}) - 0.41p_{nf} - 5.79]_{t-1}$			0.038* (0.093)	0.360* (0.079)
		Faktorë të brendshëm			
Inflacioni i brendshëm i drithërave (-1)		0.527*** (0.000)			0.028* (0.055)
Inflacioni i brendshëm i ushqimeve (-1)			0.610*** (0.000)		
Inflacioni i brendshëm joushqimor (-1)				0.109* (0.057)	
Hendeku i prodhimit bujqësor (-1)		-0.101* (0.091)	-0.081* (0.061)		-0.005* (0.087)
Huamarrja e sektorit publik		0.001 (0.814)	0.010 (0.602)	0.0002 (0.208)	0.014* (0.095)
		Faktorë të jashtëm			
Inflacioni botëror i drithërave		0.039** (0.043)			0.011** (0.042)
Inflacioni botëror i ushqimeve			0.049** (0.013)		
Inflacioni botëror joushqimor				0.034* (0.077)	
Çmimi botëror i karburanteve					0.0007* (0.059)
Inflacioni botëror i ushqimeve*dum		0.035** (0.025)	0.015** (0.037)		0.028* (0.082)
Konstante		0.001 (0.784)	0.004 (0.321)	0.003 (0.893)	0.012*** (0.000)
Obs.		67	67	67	67
R-katror e axhustuar		0.351	0.508	0.143	0.546

*Shënim: *** tregon rëndësinë statistikore në nivelin 1%, ** në 5% dhe * në 10%.*
Dum është një variabël binar që kap "pikat e mprehta" në çmimet botërore të ushqimeve.

Në periudhën afatshkurtër, një rritje e huamarrjes së sektorit publik çon në një rritje të të gjithë treguesve të inflacionit, por efekti rezulton statistikisht i rëndësishëm vetëm për inflacionin total, edhe pse efektet janë të papërfillshme. Kjo mund të shpjegohet me faktin se deficiti fiskal në Shqipëri financohet kryesisht nga obligacionet dhe huamarrja e jashtme dhe jo nga emetimi i parasë.

Rezultatet për përcaktuesit e tjerë janë pothuaj të ngjashme me ato të gjetura në modelin bazë që përfshin sektorin monetar në specifikimin afatshkurtër. Faktorët e jashtëm luajnë një rol të rëndësishëm në nxitjen e inflacionit të brendshëm, veçanërisht nëpërmjet produkteve ushqimore dhe energjetike të importuara, si dhe luhatjeve të kursit të këmbimit. Rezultatet tregojnë efekte të vazhdueshme të goditjeve në çmimet botërore në disa tregues të inflacionit të brendshëm. Inflacioni shfaq inerci, veçanërisht në rastin e drithërave dhe ushqimeve. Ndër të gjithë treguesit e inflacionit, inflacioni joushqimor shfaq një sjellje më "indiferente" dhe nuk ndikohet as nga rritja e parasë, as nga huamarrja e sektorit publik, gjë që mund të shpjegohet me faktin që ky indeks përfshin zëra për të cilët çmimet kontrollohen ose monitorohen nga afër, të tilla si karburantet dhe energjia.

5. KOMENTE PËRMBYLLËSE

Megjithëse gjetjet janë përgjithësisht në përputhje me rezultatet e studimeve ekzistuese, ky artikull thekson rëndësinë kritike të shqyrtimit të faktorëve strukturorë të anës së ofertës për të kuptuar dinamikën e inflacionit, veçanërisht zhvillimet e sektorit ushqimor në përgjithësi dhe ato në sektorin e drithërave në veçanti. Në periudhën afatshkurtër, goditjet në prodhimin e drithërave shkaktojnë rritje të çmimeve të drithërave dhe ushqimeve, me efekte që përcillen në inflacionin e përgjithshëm. Në periudhën afatgjatë, pabarazitë në çmimet relative të drithërave në Shqipëri kundrejt tregjeve botërore nxisin inflacionin në vend. Këto rezultate pasqyrojnë peshën e madhe të drithërave në konsumin familjar, ekspozimin e prodhimit të drithërave ndaj goditjeve natyrore dhe varësinë nga importi. Sektori fiskal, i cili është lënë jashtë në studimet e mëparshme, ka ndikime afatgjata dhe afatshkurtra në inflacionin në Shqipëri, megjithëse efektet janë të papërfillshme.

Rezultatet e këtij studimi konfirmojnë se ekonomia shqiptare është integruar ndjeshëm në ekonominë globale. Çmimet ndikohen fuqishëm nga çmimet relative në sektorin e drithërave dhe ushqimeve në periudhën afatgjatë dhe ndryshimet në çmimet botërore të drithërave, ushqimeve, artikujve joushqimor transmetohen në çmimet e brendshme.

Për sa i përket implikimeve politike, rezultatet empirike të këtij studimi sugjerojnë që të ndërhyhet duke lehtësuar kufizimet nga ana e ofertës dhe duke stabilizuar prodhimin e drithërave në përputhje me nevojat e kërkesës së luhatshme, që vjen nga ndryshimet e shpejta demografike dhe trendet e urbanizimit. Për më tepër, mbajtja nën kontroll e rritjes së parasë është e dëshirueshme për të shmangur përkeqësimin e presioneve të tjera mbi inflacionin si nga ana e kërkesës, ashtu dhe nga ana e ofertës. Edhe pse nga analiza këtu rezulton se efektet aktuale janë të papërfillshme, frenimi i huamarrjes së qeverisë duhet të jetë pjesë e strategjisë së kontrollit të inflacionit, për të parandaluar çdo efekt negativ të muundshëm në të ardhmen.

Megjithatë, implikimet e huamarrjes së qeverisë për inflacionin janë komplekse, pasi ato funksionojnë si në anën e kërkesës, ashtu edhe në atë të ofertës. Për shembull, kur borxhi i qeverisë përdoret për të financuar investime publike që nxisin produktivitetin dhe zgjerojnë kapacitetin prodhues të ekonomisë, si infrastruktura, teknologjia dhe inovacioni, efektet anësore të anës së ofertës mund të lehtësojnë përfundimisht presionet inflacioniste që burojnë nga ana e kërkesës. Kjo sigurisht do të kërkonte një koordinim efektiv të politikave monetare dhe fiskale, si dhe racionalizim dhe menaxhim efikas të shpenzimeve qeveritare të financuara nga borxhi.

REFERENCA

Argy, V. (1970). Structural Inflation in Developing Countries. Oxford Economic Papers 22(1): 73-95.

Bank of Albania available at: https://www.bankofalbania.org/Statistics/Time_series/
Catão, L. A.V., and M. E. Terrones (2005), Fiscal deficits and inflation. Journal of Monetary Economics 52 (3): 529–54.

Çeliku Evelina, Ermelinda Kristo, Iris Metani, Enian Çela, and Gent Hashorva (2019), "Factors behind low inflation in Albania", Bank of Albania Working Paper Series.

Durevall, D., Loening, J. L., and Birru, Y. A. (2013), 'Inflation dynamics and food prices in Ethiopia', Journal of Development Economics, 104: 89-106.

Durevall, Dick & Loening, Josef & Birru, Yohannes. (2010). Inflation Dynamics and Food Prices in Ethiopia. Journal of Development Economics. 104. 10.1016/j.jdeveco.2013.05.002.

Durevall, D., 1998. The dynamics of chronic inflation in Brazil, 1968–1985. Journal of Business and Economics Statistics 16 (4), 423–432.

INSTAT available at: http://databaza.instat.gov.al/pxweb/en/DST/.

Ghatak, S. (1995). Money, inflation and growth. In: Monetary Economics in Developing Countries. Palgrave, London. https://doi.org/10.1007/978-1-349-23895-8_6.

Gibson, Bill & Dirk Ernst Van Seventer (2000), "A Tale of Two Models: Comparing structuralist and neoclassical computable general equilibrium models for South Africa", International Review of Applied Economics, Taylor & Francis Journals, vol. 14(2), pages 149-171. https://ideas.repec.org/a/taf/irapec/v14y2000i2p149-171.html.

Gordon, D. B., and E. M. Leeper (2006), The price level, the quantity theory of money, and the fiscal theory of the price level. Scottish Journal of Political Economy 53 (1): 4–27.
Kinda, A. (2011), 'Modeling Inflation in Chad', International Monetary Fund, Working Paper WP/11/57.

Mawejje, J. and Lwanga, M.M. (2016), «Inflation dynamics and agricultural supply shocks in Uganda», African Journal of Economic and Management Studies, Vol. 7 No. 4, pp. 547-567. https://doi.org/10.1108/AJEMS-07-2015-0079.

Papavangjeli, Meri (2019), "Forecasting the Albanian short-term inflation through a Bayesian VAR model", Graduate Institute of International and Development Studies Working Paper, No. 16-2019, Graduate Institute of International and Development Studies, Geneva.

Pinga, V. E. B., & Nelson, G. C. (2001). Money, Prices and Causality: Monetarist versus structuralist explanations, Using Pooled Country Evidence. Applied Economics, 33(10), 1271-1281. https://doi. org/10.1080/00036840122078.

Skufi, L. dhe E. Kika (2019), "Formimi i çmimeve në ekonominë shqiptare - një përqasje makromodeluese," Material studimi i Bankës së Shqipërisë.

Skufi, L. dhe E. Çela (2017), "Inflacioni i importuar i mallrave të konsumit dhe kontributi i tij në inflacionin e përgjithshëm", Material studimi i Bankës së Shqipërisë.

Tanku, Altin dhe Ilir Vika (2020), What drives the real lek-euro exchange rate fluctuations?, Bank of Albania Working Paper Series.

Taylor, L. (1983). Structuralist Macroeconomics. New York: Basic Books.
Thirlwall, A.P. (1974). Inflation, Saving and Growth in Developing Economies. London: Macmillan.

Vika, Ilir & Rama, Arlind (2017). Pricing to market effects in Albania: How competitive is the external sector?. Bank of Albania Economic Review. 31-44.

World Bank Commodity Price Data (The Pink Sheet) available at: https://www.worldbank.org/en/research/commodity-markets

Yeldan, A. E. (1993). Conflicting Interests and Structural Inflation: Turkey, 1980-1990. The Pakistan Development Review, 32(3), 303–327. http://www.jstor.org/stable/41259662.

SHTOJCË

Tabela A1. Përshkrimi i variablave

Treguesi	Emri i variablit	Burimi
Inflacioni total	Δp	INSTAT
Inflacioni i drithërave	$\Delta p^{cereals}$	INSTAT, llogaritje të autorit
Inflacioni i ushqimeve	Δp_{food}	INSTAT
Inflacioni joushqimor	Δp_{nfood}	INSTAT, llogaritje të autorit
Hendeku i prodhimnit bujqësor	$agrigap$	INSTAT, llogaritje të autorit
Rritja e parasë	Δm	Banka e Shqipërisë
Huamarrja e sektorit publik	Δpub	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Deficiti primar	$\Delta prim$	Ministria e Financave dhe Ekonomisë, llogaritje të autorit
Inflacioni botëror i drithërave	$\Delta p^{w}_{cereals}$	World Bank Commodity Price Data (The Pink Sheet)
Inflacioni botëror i ushqimeve	Δp^{w}_{food}	World Bank Commodity Price Data (The Pink Sheet)
Inflacioni botëror joushqimor	Δp^{w}_{nfood}	World Bank Commodity Price Data (The Pink Sheet), llogaritje të autorit
Çmimi i karburanteve	Δp^{w}_{oil}	World Bank Commodity Price Data (The Pink Sheet)
Kuris i këmbimit (ALL/EUR)	Δer	Banka e Shqipërisë për kursin nominal të këmbimit (ALL/EUR), INSTAT për inflacionin e brendshëm, EUROSTAT për inflacionin në Eurozonë, dhe llogaritje të autorit.

Tabela A2. Rezultatet e testeve të stacionaritetit
Hipoteza zero (H0): Variabli ka një rrënjë njësi

	Rezultatet e testeve të stacionaritetit (vlera e p-së)	
Variabli	Nivel	Diferenca e parë
Oferta e parasë	0.939	0.0001***
PBB	0.113	0.0001***
Kursi i këmbimit (ALL/EUR)	0.969	0.0018***
Borxhi publik	0.801	0.0001***
Deficiti fiskal primar	0.069	0.0000***
Indeksi i çmimeve të brendshme të ushqimeve	0.853	0.0001***
Indeksi i çmimeve të brendshme të artikujve joushqimorë	0.762	0.0000***
Indeksi i çmimeve botërore të ushqimeve	0.756	0.0000***
Indeksi i çmimeve botërore të artikujve joushqimorë	0.671	0.0000***

** Hipoteza zero hidhet poshtë në nivelin e rëndësisë 10%;*
*** Hipoteza zero hidhet poshtë në nivelin e rëndësisë 5%;*
**** Hipoteza zero hidhet poshtë në nivelin e rëndësisë 1%.*

Tabela A3. Rezultatet e testeve të kointegrimit

	Trendi i të dhënave	Asnjë	Asnjë	Linear	Linear	Kuadratik
	Tipi i testit	Jo intercept Jo trend	Intercept Jo trend	Intercept Jo trend	Intercept trend	Intercept trend
Sektori monetar	Testi i gjurmës	1	1	1	2	3
	Testi i vlerës së vet maksimale	1	1	1	1	1
Sektori i ushqimeve	Testi i gjurmës	1	1	0	0	0
	Testi i vlerës së vet maksimale	1	1	0	0	0
Sektori joushqimor	Testi i gjurmës	1	0	1	0	2
	Testi i vlerës së vet maksimale	1	0	1	1	2

NEVOJA PËR TË KONSIDERUAR MENAXHIMIN E RREZIKUT TË KLIMËS EDHE NGA BANKAT NË SHQIPËRI

Lindita Molishti[1], Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë

HYRJE

Materializimet fizike të ndryshimeve të klimës janë gjithnjë e më të dukshme në të gjithë globin, siç janë bërë të prekshme dhe ndikimet e tyre socio-ekonomike. Të dy këto fenomene do të vijojnë të rriten në mënyrë jolineare, derisa bota të kalojë në një ekonomi me net-zero emision dhe t'i përshtatet këtyre ndryshimeve. Ndryshimet klimatike, tashmë falë edhe shumë studimeve të shkencës së klimës, nuk perceptohen si të lidhur veç me ngrohjen globale, por edhe si një kombinim i disa faktorëve të tjerë (efektit "greenhouse" i shtohet emetimit të karbonit nga aktiviteti ekonomik), të cilët kanë sjellë si rezultat tashmë të provuar që planeti ynë po ngrohet çdo vit përtej nivelit të një ngrohjeje të sigurt.

Ndryshimet klimatike sjellin dhe ndryshime në shkallë të madhe të ekosistemeve kyçe të planetit edhe këto ndryshime fatkeqësisht nuk janë lineare. Për të ngritur ndërgjegjësimin dhe për ta bërë më të prekshëm rrezikun e klimës, shkenca e klimës ka provuar me shembuj specifië për çdo ekosistem kërcënimin nga ndryshimi klimatik si p.sh. nëse ndodh ngrohja e planetit me 2 gradë celsius në vend të 1.5 gradë celsius do të sillte zhdukjen e kreshtave të koraleve në dete[2] në planet dhe do të ekspozonte rreth 37% të popullsisë botërore ndaj nxehtësisë ekstreme çdo 5 vjet[3]. Ndryshime të tilla në ekosisteme do e bënin planetin tonë të pabanueshëm (World Bank 2020).[4]

Nevoja për një përgjigje globale është materializuar në nisma dhe aleanca për veprime drejt përmirësimit urgjent të këtyre efekteve dhe sigurimit të një planeti të sigurt për vazhdimësinë e jetës në të. Katalizator për këto veprime është Marrëveshja e Parisit 2015[5], e nënshkruar nga 197 palë (anëtare të Kombeve të Bashkuara). Qëllimi është të "forcojë reagimin global ndaj kërcënimit të ndryshimeve klimatike, duke mbajtur një rritje të temperaturës globale këtë shekull nën 2 gradë celsius mbi nivelet paraindustriale dhe të vazhdojë përpjekjet për të kufizuar rritjen e temperaturës edhe më tej në 1.5

---

[1] *Falënderoj z. Kliti Ceca për komentet dhe sugjerimet e vlefshme.*

[2] *Termi në anglisht "coral reefs".*

[3] *Timothy M. Lenton, Hermann Held, Elmar Kriegler, Jim W. Hall, Wolfgang Lucht, Stefan Rahmstorf "Tipping elements in the Earth's climate system" https://www.pnas.org/doi/10.1073/pnas.0705414105*

[4] *World Bank. 2020. "Reversals of Fortune." Poverty and Shared Prosperity report, Washington D.C.*
World Ocean Review. 2020. Fisheries. Accessed April 10, 2020. https://worldoceanreview.com/en/wor-1/fisheries/fisheries-management/

[5] *Detajet e premtimeve ndryshojnë. Lista e përditësuar e "Aleancës së Ambicieve Klimatike: Net Zero 2050" mund të gjendet në https://climateaction.unfccc.int/views/cooperative-initiative-details.html?id=94.*

gradë Celsius"[6] (UNFCCC 2020). Çdo vend supozohet të paraqesë planin e vet të përpjekjeve për zbutjen dhe përshtatjen – të ashtuquajturin kontribut të përcaktuar në nivel kombëtar (NDCs)[7]- dhe një agjenci e posaçme e OKB-së (sekretariati i UNFCCC) është përgjegjëse për ndjekjen e progresit. Shqipëria e ka nënshkruar marrëveshjen e Parisit në dhjetor 2017 dhe ka aprovuar në parlament agjendën 2030 me angazhimet ndaj zhvillimit të qëndrueshëm. Në janar 2019, Shqipëria ratifikoi Amendamentin Kigali të Protokollit të Montrealit[8]. Marrëveshja synon të zvogëlojë përdorimin e hidrofluorokarbureve (HFC), gazeve të fuqishme serë të përdorura kryesisht në pajisjet e ftohjes, ajrit të kondicionuar dhe pompës së nxehtësisë, të cilat janë mijëra herë më të dëmshme për klimën sesa CO_2. Gjithë kuadri ligjor udhëzues, duke përfshirë edhe strategjinë kombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm, si dhe planin e masave, është në fuqi.

Ndërgjegjësimi për kërcënimin nga ndryshimet klimatike solli që në dhjetor 2017, të krijohej "Supervisors Network for Greening the Financial System (NGFS)"[9] nga një grup bankash qendrore dhe mbikëqyrësish të gatshëm për të kontribuuar në zhvillimin e një mjedisi për administrimin e rrezikut të klimës në sektorin financiar dhe për të mobilizuar financa në mbështetje të tranzicionit drejt një ekonomie të qëndrueshme.

NGFS pranoi se "rreziqet në lidhje me klimën janë një burim rreziku financiar, prandaj është brenda mandateve të bankave qendrore dhe mbikëqyrësve që sistemi financiar të jetë i qëndrueshëm ndaj këtyre rreziqeve" (NGFS (2018)). NGFS ka publikuar udhëzues për ndërtimin e metodologjive dhe kontribuon në vazhdimësi nëpërmjet ndarjes së praktikave më të mira në menaxhimin e rrezikut të mjedisit dhe klimës në sektorin financiar. Për të mësuar dhe për të kontribuuar në përpjekjet globale drejt rritjes së rolit të sistemit financiar për të menaxhuar rreziqet e klimës, Banka e Shqipërisë u bashkua me Rrjetin për Gjelbërimin e Sistemit Financiar (NGFS) si bankë qendrore anëtare në vitin 2020[10] (Sejko 2022). Banka e Shqipërisë pret të përfitojë nga anëtarësimi në NGFS, duke mësuar nga bankat qendrore anëtare dhe duke kontribuuar në përpjekjet globale për financat e gjelbra dhe në kontekstin më të gjerë për një zhvillim të qëndrueshëm mjedisor.

VËSHTIRËSIA E KRIJIMIT TË NJË MODELI MBI RREZIQET E KLIMËS

Nisur dhe nga metodologjitë e publikuara nga NGFS, Banka e Shqipërisë po inicion jo vetëm ndërgjegjësimin për nevojën e veprimeve ndaj ndryshimeve

[6] *UNFCCC. 2020. "Paris Agreement." United Nations Framework Convention on Climate Change. Accessed March 10, 2020. https://unfccc.int/process-and-meetings/the-paris-agreement/the-paris-agreement.*

[7] *Third National Communication of the Republic of Albania under the United Nations Framework Convention on Climate Change Tirana, June 2016*

[8] *https://www.unido.org/news/albania-steps-fight-against-climate-change*

[9] *https://www.ngfs.ne*

[10] *https://www.bankofalbania.org/Botime/Botime_te_vecanta/Banka_qendrore_dhe_politikat_e_saj_ne_kohen_e_Covid-19_Sfidat_per_te_ardhmen.html f. 234*

klimatike, por po studion dhe vlerëson ndikimin e mundshëm të rreziqeve të klimës në ekonomi dhe veçanërisht në stabilitetin financiar.

Vlerësimi i ndikimit të rreziqeve të klimës në ekonomi është shumë kompleks. Rreziqet e drejtpërdrejta nga rreziqet klimatike përcaktohen nga ashpërsia e rrezikut klimatik dhe shpeshtësia e tij. Ekspozimi ndaj këtyre rreziqeve prek të gjitha burimet dhe kapitalet e ekonomisë, si atë njerëzor e financiar, ashtu dhe kapitalin natyror.

Studimi i literaturës na tregon se modelet e deritanishme i kanë parë ekosistemet natyrore si aset me vlerë për përdorim imediat dhe jo si kapital bazë që mundëson vazhdimësinë e ekzistencës njerëzore. Kjo për faktin se kapitali natyror është kompleks dhe i vështirë të matet vetëm me konceptin ekonomik. Tregjet financiare nuk e njohin vlerën e kapitalit natyror nëse nuk kanë të përcaktuar fluksin e mjeteve monetare që vjen prej tij ose vlerësimin si aset që mund të matet në modelet aktuale ekonomike. Si rezultat, vlera reale e përdorimit si dhe kostot reale të shkatërrimit të këtyre sistemeve natyrore nuk janë konsideruar të plota[11] (Defries et al. 2019). Në dallim nga format e tjera të kapitalit, kapitali natyror nuk amortizohet, pasi ka në vetvete aftësinë vetërigjeneruese, por kur abuzimi në përdorimin e një ekosistemi të caktuar arrin në një pikë ku vetëgjenerimi humbet, atëherë kolapsi i ekosistemit është i pakthyeshëm[12]. Për të bërë vlerësimin e duhur të natyrës, në modelet tona ekonomike duhet të përfshijmë shkencën e klimës nëpërmjet përcaktimit që ajo bën për pikat e kthesës dhe specifikat e ekosistemeve. Kohët e fundit, studiuesit po ndjekin këtë qasje dhe së bashku me shkencën e klimës kanë bërë vlerësime të tilla si afërsisht 44 trilionë dollarë të GDP-së globale është i varur nga natyra dhe shërbimet që ajo ofron[13].

Ekzistojnë tre lloje kryesore të rreziqeve klimatike: rreziqet fizike, të tranzicionit dhe ato ligjore (Carney 2015)[14]. Rreziqet fizike lindin nga rreziqet klimatike dhe ndryshimet afatgjata në modelet klimatike. Rreziqet e tranzicionit rrjedhin nga procesi i ndryshimit strukturor i nevojshëm në tranzicionin drejt një ekonomie me karbon të ulët, duke përfshirë ndryshimet në politikat klimatike, teknologjitë, sjelljen e konsumatorëve dhe preferencat e investitorëve.

Kombinimet e rreziqet e mundshme fizike nga kërcënimet e klimës, vijnë nga të gjithë sektorët e ekonomisë: ndërtimi, bujqësia, financa, peshkimi, turizmi, prodhimi, pasuritë e paluajtshme dhe nga infrastruktura. Për të vlerësuar ndikimet e mundshme të rreziqeve të klimës në ekonomi duhen marrë në konsideratë variablat që përfshijnë gjithë spektrin e "inputeve" dhe "outputeve" për çdo sektor, të tilla si: rreziku i jetës dhe paaftësia për të punuar deri tek

[11] *DeFries, R., O. Edenhofer, et al (2019): The Missing Economic Risks in Assessments of Climate Change Impacts. Grantham Research Institute on Climate Change and the Environment.*

[12] *C. Herweijer et al. (2020), Nature Risk Rising: Why the Crisis Engulfing Nature Matters for Business and the Economy, World Economic Forum, http://www3.weforum.org/docs/WEF_New_Nature_Economy_Report_2020.pdf.*

[13] *C. Herweijer et al. (2020), Nature Risk Rising: Why the Crisis Engulfing Nature Matters for Business and the Economy, World Economic Forum, http://www3.weforum.org/docs/WEF_New_Nature_Economy_Report_2020.pdf.*

[14] *https://www.bankofengland.co.uk/speech/2015/breaking-the-tragedy-of-the-horizon-climate-change-and-financial-stability*

mungesa e furnizimit me ushqim apo dëmtimi fizik i aseteve dhe infrastrukturës. Për më tepër, kanalet e transmetimit të tyre në ekonomi duhen perceptuar si direkte dhe indirekte. Diapazoni i variablave shtohet pasi, përveç rreziqeve direkte, janë edhe rreziqet e tranzicionit, të cilat kërkojnë kosto dhe ndërhyrje strukturale në sektorë kyç të ekonomisë. Ndërveprimi kompleks i variablave (si mikro dhe makroekonomike me variablat sociale dhe ato të ekosistemeve natyrore) e bën të vështirë çdo modelim të efekteve të rreziqeve të klimës në ekonomi.

Ndërkohë çdo vonesë për veprime në drejtim të rreziqeve nga ndryshimet e klimës nga ana e sektorit bankar do ishte me kosto të paripërueshme, ndaj gjithmonë dhe më shumë banka po nxiten të menaxhojnë rreziqet e klimës, të pa detyruara nga presione rregullative. Financimi i një agjende të gjelbër ka filluar të jetë pjesë e logove të bankave dhe pjesë e agjendave të kreditimit bankar[15]. Disa grupe të mëdha bankare në Evropë, pas studimit të planeve për dekarbonizimin e ekonomive të tyre dhe parashikimit të nevojave për adaptimin e sektorëve drejt ekonomive me emision karboni net-zero, tashmë kanë marrë vendime të rëndësishme strategjike, duke nxitur financat e qëndrueshme, duke ofruar nxitje dhe interesa preferenciale për huanë e gjelbër dhe duke mobilizuar kapital të ri për iniciativat mjedisore. E rëndësishme tani është që të veprohet me vendosmëri dhe bindje, në mënyrë që menaxhimi efektiv i rreziqeve të klimës të kthehet në aftësi për të krijuar dhe ngritur strukturat përkatëse nëpër banka.

Si pjesë e një përpjekjeje të vazhdueshme kërkimore, ky material ka për qëllim të sjellë në vëmendje të bankave në Shqipëri nevojën për të marrë në konsideratë rrezikun e klimës në kuadrin dhe në politikën e tyre të menaxhimit të rreziqeve. Bankave do u duhet të krijojnë një strukturë të re dhe të ngrenë aftësinë e tyre për të menaxhuar rreziqet e klimës, një detyrë e cila, në mungesë të të dhënave të disponueshme për çdo sektor të ekonomisë apo edhe të një harte udhëzuese mbi fazat e arritjes se objektivit 1.5 gradë celsius, nuk është e lehtë. Me qëllim që jo vetëm të tërheqim vëmendjen e bankave për rrezikun e klimës, por për t'u ardhur në ndihmë nëpërmjet këtij materiali, po përpiqemi të thjeshtojmë kompleksitetin e një modeli dhe, në mënyrë analitike, po përshkruajmë situatën e rreziqeve të klimës në vendin tonë, si dhe shkallën e ekspozimit të mundshëm të ekonomisë shqiptare ndaj ndryshimeve të klimës.

FINANCIMI I POLITIKAVE MJEDISORE

Roli i financave në politikat e ndryshimeve klimatike theksohet në nenin 2 të Marrëveshjes së Parisit, i cili bën thirrje për "ngritjen e flukseve financiare në përputhje me një rrugë drejt emetimeve të ulëta të gazeve serrë dhe zhvillimit të qëndrueshmen ndaj klimës" (UNFCCC 2020)[16].

[15] *IMF. 2020a. "Global Financial Stability Report No. 2020/001." Independent Experts Group on Climate Finance. 2020. "Delivering on the $100 Billion Climate Finance Commitment and Transforming Climate Finance."*

[16] *UNFCCC 2020. https://unfccc.int/ https://unfccc.int/documents*

Në një këndvështrim prej ekonomiksi, ekosistemet natyrore janë në thelb kapitali natyror[17] bazë (i ngjashëm me atë financiar apo kapitalin njerëzor) që siguron vazhdimësinë e shërbimeve për njerëzit. Këto "shërbime të ekosistemeve", që sistemet dhe modelet ekonomike shumë herë i marrin të mirëqena, përfshijnë:

1) tokën pjellore dhe pllenimin që mundësojnë prodhimin bujqësor d.m.th mundësojnë ushqimin. Studimi i fundit vlerëson se humbja mbarëbotërore e të gjithë pjalmuesve do të çonte në një rënie të prodhimit vjetor bujqësor prej rreth 217 miliardë dollarë amerikanë[18];
2) pyjet të cilat mundësojnë tërheqjen e karbonit nga ajri i ndotur i qendrave industriale që prodhojnë makineritë d.m.th. mundësojnë oksigjenin. Hulumtimi i fundit i shkencës së klimës ka vlerësuar: se për një vlerë deri në 600 dollarë për ton CO2 të pastruar nga ajri, do të nënkuptonte një vlerë monetare për pyjet në rolin e tyre si thithës karboni më shumë se 100 trilionë dollarë[19];
3) lumenjtë dhe pellgjet ujëmbledhëse, të cilat pastrojnë ujërat dhe mundësojnë furnizim me ujë të pijshëm në tryezat e njerëzve;
4) biodiversiteti gjenetik bimor, i cili mundëson prodhimet farmaceutike të domosdoshme për shëndetin tonë. Aktualisht, vlerësohet se më shumë se 1/3 e farmaceutikëve në përdorim sot janë të varur nga diversiteti bimor në natyrë.[20]

E ndërsa ekonomistët në ndërveprim me shkencën e klimës do të punojnë drejt vlerësimit të duhur të natyrës në modelet ekonomike, një nevojë emergjente është investimi në ndalimin e degradimit të ekosistemeve të dëmtuar dhe investimin në rigjenerimin e ekosistemeve natyrore, si dhe investimi në mbrojtjen e atyre që kanë mundur të vetërigjenerohen.

Për efekt të studimit dhe lidhjes dhe efektit në sistemin financiar, "NGFS" i ka specifikuar rreziqet e klimës në 2 kategori të mëdha: rreziqe mjedisore dhe rreziqe të ndryshimeve klimatike. Rreziqet mjedisore i referohen ekspozimeve të sistemit financiar ndaj aktiviteteve që mund të shkaktojnë apo ndikojnë në degradimin e mjedisit (të atyre ekosistemeve që përmendëm më sipër si ndotja e ujërave dhe e ajrit, kontaminimi i tokës dhe shpyllëzimi apo reduktimi i biodiversitetit). Rreziqet e ndryshimit të klimës i referohen rreziqeve të paraqitura nga ekspozimi i sektorit financiar ndaj rreziqeve fizike ose të tranzicionit të shkaktuara ose të lidhura me ndryshimin e klimës (siç është dëmtimi i shkaktuar nga ngjarjet ekstreme të motit ose një rënie e vlerës së aseteve në sektorët me intensitet të lartë karboni).

---

[17] *Koncepti i kapitalit natyror është përcaktuar nga "Natural Capital Committee" https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/516707/ncc-state-natural-capital-first-report.pdf*

[18] *Helmholtz Association of German Research Centres (2008, September 15), Economic Value of Insect Pollination Worldwide Estimated at U.S. $217 Billion. ScienceDaily. Retrieved March 1, 2011, from http://www.sciencedaily.com/releases/2008/09/080915122725.htm*

[19] *C. Herweijer et al. (2020), Nature Risk Rising: Why the Crisis Engulfing Nature Matters for Business and the Economy, World Economic Forum, http://www3.weforum.org/docs/WEF_New_Nature_Economy_Report_2020.pdf*

[20] *D. J. Newman and G. M. Cragg, Natural products as sources of new drugs over the 30 years from 1981 to 2010. J Nat Prod. 2012;75(3):311–335. doi:10.1021/ np200906s*

Ashtu si për "NGFS" edhe për vendin tonë i rëndësishëm është fokusimi më tepër në rreziqet që lidhen me klimën se sa me rreziqet mjedisore për dy arsye: së pari, tranzicioni në një ekonomi me karbon të ulët në përputhje me objektivat e "Marrëveshjes së Parisit" kërkon një ndryshim rrënjësor të shpërndarjes së burimeve dhe, si rrjedhim, një përgjigje thelbësore nga ana e sektorit financiar. Dhe, së dyti, në hartën e rreziqeve, Shqipëria është më tepër e ekspozuar ndaj rreziqeve të klimës më shumë se sa ndaj rreziqeve mjedisore[21].

Financat e gjelbra përkufizohen për herë të parë nga "Grupi i Studimit të Financave të Qëndrueshme të G20-ës" si "financimi i investimeve që ofrojnë përfitime mjedisore në kontekstin më të gjerë të zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor"[22]. Në nivel global, kërkesa për shërbime financiare të gjelbra është rritur ndjeshëm si pjesë e tranzicionit drejt një ekonomie me emision karboni net-zero. Për shembull, studimi i McKinesey mbi Bashkimin Evropian drejt përshtatjes për qasjen "nën një 1.5°C", ka vlerësuar dhe gjetur "se duhet që numri i paneleve diellore të instaluara në javë të jetë afërsisht tetë herë më i lartë se numri i sotëm dhe se shkalla e instalimeve të turbinave me erë do të duhet të rritet pesëfish".[23]

Investimi në energjinë e rinovueshme, impiantet rinovuese apo edhe teknologjitë adaptive kërkojnë nivele të konsiderueshme financimi. Këto investime përveç përmirësimeve në drejtim të emetimeve të karbonit, duhen parë edhe si oportunitet fitimprurëse për bankat. Nafta dhe gazi, prodhimi i energjisë elektrike, pasuritë e paluajtshme, industria e transportit, makinat elektrike dhe bujqësia paraqesin mundësi të rëndësishme për investime të gjelbra.

Ndërsa tranzicioni do të krijonte oportunitete zhvillimi, kompanitë që prodhojnë apo operojnë nën emetime të larta (dioksid karboni CO2, metani CH4, oksid azoti N2O) dhe që janë kryesisht në sektorët e energjisë, të transportit, të industrisë nxjerrëse, përpunuese dhe kimike në bujqësi dhe blegtori), do të përballen me efekte në kërkesë, në kostot të prodhimit apo dhe punësim.

Por duke qenë se efektet e prekshme dhe kthimi i këtyre investimeve është afatgjatë dhe shumë herë përtej maturiteteve tradicionale të kreditimit afatgjatë, bankat e kanë të vështirë të gjejnë nxitjet e duhura dhe të vlerësojnë efektet pozitive gjithëpërfshirëse të këtyre investime dhe efektet katastrofike nga mungesa e këtyre investimeve.

Banka Qendrore Evropiane në 22 shtator 2021 publikoi rezultatet e ushtrimit të stres-testit të rreziqeve të ndryshimeve të klimës për 1600 banka të zonës së euros[24]. Gjetjet e rezultatet e stres-testit treguan se:

---

[21] *Third National Communicationof the Republic of Albania under the United NationsFramework Convention on Climate Change Tirana, June 2016.*

[22] *Green Finance and the Resilience of the Financial Sector to Climate Change*

[23] *How the European Union could achieve net-zero emissions at net-zero cost," McKinsey & Company, December 2020. Paolo d'Aprile, Hauke Engel, Godart van Gendt, Stefan Helmcke, Solveigh Hieronimus, Tomas Nauclér, Dickon Pinner, Daan Walter, and Maaike Witteveen.*

[24] *https://www.ecb.europa.eu/pub/pdf/scpops/ecb.op281~05a7735b1c.en.pdf*

- bankat do të preken rëndë nëse çështjet e ndryshimeve klimatike nuk trajtohen sa më shpejtë;
- një tranzicion i rregullt dhe i shpejtë për të minimizuar kostot dhe për të maksimizuar përfitimet do të tejkalojë koston afatshkurtër të tranzicionit në ekonominë me zero karbon për një periudhë afatmesme dhe afatgjatë;
- investimet në sektorë dhe rajone shumë të ekspozuara ndaj rrezikut të klimës do të vuajnë më shumë.

Rezultatet tregojnë se edhe bankat do përfitojnë nga miratimi i politikave të gjelbra që herët për të nxitur kalimin drejt një ekonomie me emision karboni net-zero. Ushtrimi zbulon gjithashtu se ndikimi i rrezikut klimatik është i përqendruar në rajone dhe sektorë të caktuar të Eurozonës. Në veçanti, firmat e vendosura në rajonet më të ekspozuara ndaj rrezikut fizik mund të përballen me fatkeqësi natyrore shumë të rënda dhe të shpeshta, të cilat nga ana e tyre do të ndikojnë në aftësinë e tyre kreditore.

Sfida nga rreziqet e ndryshimeve të klimës u kërkon bankave që të identifikojnë, të matin, të vlerësojnë dhe të monitorojnë ekspozimin ndaj rrezikut të klimës për portofolin e tyre aktual, si dhe të rishikojnë politikat e tyre të kreditimit dhe indikatorët për çdo kreditim të ardhshëm. Një ndihmesë për bankat do të ishte krijimi i një baze të dhënash në lidhje me rreziqet fizike dhe ato të tranzicionit për çdo sektor të ekonomisë, me qëllim të kuptuarit e qartë të madhësisë së rreziqeve fizike dhe ndërtimin e kanaleve të transmisionit të këtyre rreziqeve në ato financiare për kapitalin e bankës. Të pasurit e strategjive dhe planet e veprimit për adoptimin dhe minimizimin e rreziqeve të klimës për çdo sektor të ekonomisë nga qeveria do i ndihmonte bankat të modelonin rreziqet e tranzicionit dhe kostot që ato mbartin, si dhe të planifikonin kreditimet e ardhshme drejt projekteve të sigurta mjedisore.

Në mungesë të "hartës së rreziqeve klimatike" po përpiqemi të mbledhim nga studime të ndryshme rreziqet e mundshme që kanosin Shqipërinë dhe sektorët delikatë ndaj rreziqeve klimatike, duke shpresuar që bankat të mund të ndërtojnë hartën e tyre të ekspozimeve ndaj rreziqeve të klimës, si për rreziqet fizike ashtu edhe për ato të tranzicionit, duke identifikuar ekspozimin e tyre ndaj sektorëve që kanë barrën kryesore në procesin e dekarbonizimit.

ÇFARË DIMË DERI MË TANI PËR EKSPOZIMIN E SHQIPËRISË NDAJ RREZIQEVE KLIMATIKE?

NGA RREZIKU FIZIK I KLIMËS TE RREZIKU FINANCIAR I SAJ

Ndërsa temperaturat mesatare rriten, rreziqet fizike si valët e të nxehtit dhe përmbytjet, rriten në frekuencë dhe ashpërsi, ndërsa rreziqe kronike, të tilla si thatësira dhe rritja e nivelit të detit, intensifikohen. Për të stabilizuar klimën dhe për të kufizuar rreziqet fizike të saj, shkenca klimatike na thotë se është e nevojshme të reduktohet shtimi i gazrave serë (dioksid karboni CO_2, metani

CH4, oksid azoti N2O) në atmosferë në net-zero dhe të kufizohet ngrohja deri në 1.5°C mbi nivelet paraindustriale, për të reduktuar pasojat e rrezikshme dhe të pakthyeshme të ndryshimeve klimatike[25].

Plani i veprimit të qeverisë shqiptare, sipas edhe angazhimit të marrë në marrëveshjen e Parisit, është publikuar në vitin 2016 në faqen zyrtare të Ministrisë së Mjedisit[26] dhe në faqen e OKB-së për ndryshimin e klimës[27].

Ky plan është i strukturuar sipas sektorëve[28] dhe angazhimet janë marrë bazuar në të dhënat e vitit 2009. Duke kërkuar për të dhëna më të vonshme në punët dhe studimet e Grupit të Bankës Botërore gjendet edhe profili për Shqipërinë për rrezikun klimatik. Ky profil është pjesë e një serie të profileve të vendeve të ndryshme, zhvilluar nga Grupi i Bankës Botërore (WBG) për rrezikun klimatik, si një burim referimi për të ndihmuar në integrimin dhe planifikimin e hartimit të politikave mjedisore. Këto të dhëna bazohen në publikimin e Ministrisë së Mjedisit të vitit 2016. Të dhëna më të shumta gjenden nga qendra të studimeve të klimës mbi rajonin në përgjithësi.

RREZIQET FIZIKE TË KLIMËS

Rreziqet fizike përfshijnë kostot ekonomike dhe humbjet financiare që vijnë nga ashpërsia dhe shpeshtësia në rritje e ngjarjeve ekstreme të motit, të lidhura me ndryshimet klimatike (si p.sh valët e të nxehtit, rrëshqitjet e dheut, përmbytjet, zjarret dhe stuhitë), si dhe zhvendosjet progresive afatgjata të klimës (si p.sh ndryshime në reshje, ndryshueshmëri ekstreme të motit, rritje të nivelit të detit dhe temperaturave mesatare).

SHQIPËRIA ËSHTË VENDI MË I KËRCËNUAR NË EVROPË NGA RREZIQE TË SHUMTA[29]

Qendra Ndërkombëtare e Monitorimit Mjedisor (Centro Internazionale in Monitoraggio Ambientale) (CIMA) dhe Zyra e Kombeve të Bashkuara për Reduktimin e Rrezikut të Fatkeqësive (UNISDR) kanë kryer kërkime të ndryshme bazuar në të dhënat e kaluara nga fatkeqësitë në Shqipëri gjatë periudhës 1851-2013. Raporti[30] ofron njohuri interesante mbi gjasat dhe pasojat e llojeve të ndryshme të ngjarjeve të rrezikshme.

---

[25] *Summary for policymakers, in Climate change 2021: The physical science basis: Contribution of Working Group I to the Sixth Assessment Report, IPCC, 2021.7*

[26] *https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2021/10/6.-Komunikimi-i-Tret%C3%AB-Komb%C3%ABtar-i-Republik%C3%ABs-s%C3%AB-Shqip%C3%ABris%C3%AB-drejtuar-Konvent%C3%ABs-Kuad%C3%ABr-t%C3%AB-Kombeve-t%C3%AB-Bashkuara-mbi-Ndryshimet-Klimatike_Qershor-2016.pdf*

[27] *Third National Communication of the Republic of Albania under the United Nations Framework Convention on Climate Change. URL: https://unfccc.int/sites/default/files/resource/Albania%20NC3_13%20October%202016.pdf*

[28] *Të dhënat nuk janë të përditësuara.*

[29] *https://www.financialprotectionforum.org/publication/disaster-risk-finance-diagnostic-albania*

[30] *https://www.gfdrr.org/Albania*

Shtatë lloje fatkeqësish janë marrë parasysh në raport, duke përfshirë ato:

- gjeofizike: tërmete, ortekë dhe sedimentime;
- meteorologjike: stuhi dëbore, shi, stuhi ere, stuhi breshëri, stuhi, mjegull, valë të ftohti, valë të nxehti dhe ngrica;
- hidrologjike: përmbytje, përmbytje e shpejtë dhe rritje;
- rrëshqitje të tokës: lëvizje masive e thatë dhe e lagësht;
- klimatologjike: zjarri në pyje dhe thatësira;
- biologjike: epidemia dhe murtaja;
- teknologjike: rrjedhje, struktura, kontaminim, shpërthime, aksident dhe zjarr;

Informacion nga Baza e të Dhënave të Ngjarjeve Emergjente (EM-DAT) nga viti 1967-2018

Ngjarja	Ndodhur (sa herë ka ndodhur ngjarja)	Pasojat (të shprehur në individë të prekur)
Thatësira dhe zjarre	2	3,200,000
Tërmete	6	8,429
Epidemi	2	292
Temperatura ekstreme	5	237,235
Përmbytje	15	205,584
Rrëshqitje	1	26
Stuhi	2	525,000

Burimi: https://www.desinventar.net/DesInventar/profiletab.jsp.

Shembull që na tregon qartë ndikimin shkatërrues të një fatkeqësie natyrore është si ai i tërmetit të vitit 2019, magnituda e të cilit ishte më e flarta në 30 vitet e fundit. Ky tërmet shkaktoi dëme të mëdha, në total 121.21 miliardë lekë (1.1 miliardë dollarë), në 11 bashki, përfshirë kryeqytetin e qendrën ekonomike të Tiranës (35 miliardë lekë ose 318 milionë dollarë amerikanë) dhe qendrën kryesore turistike të Durrësit (lekë 37.4 miliardë ose 340 milionë dollarë). Sipas raportit të PDNA[31], dëmet e shkaktuara nga tërmeti Durrës-Mamurras janë vlerësuar në ekuivalentin e 6.4 për qind të PBB-së 2018, dhe humbjet janë vlerësuar në 1.1 për qind të PBB-së[32].

Sektorët ekonomikë më të goditur ishin turizmi dhe pronat e paluajtshme për sa i përket humbjeve, por dëme të konsiderueshme i janë shkaktuar edhe arsimit, shëndetësisë, infrastrukturës publike, prodhimit, tregtisë dhe bujqësisë.

Shqipëria ka disa zona klimatike, të cilat variojnë nga ultësira me një fushë bregdetare në perëndim me malet në veri, lindje dhe jug. Një klimë me verë të nxehtë dhe dimër të freskët dhe të lagësht dhe me rrezikun e lartë të përmbytjeve lumore si nga reshjet ashtu edhe nga shkrirja e dëborës. Përmbytjet janë të shpeshta dhe tipike për periudhën nëntor – mars. Për shembull, ndikimet e një ngjarjeje të tillë si përmbytja në Shqipëri e dhjetorit 2017 kishte pasoja katastrofike, me 1575 persona të evakuuar, 3500 shtëpi të përmbytura, 65 ura të shembura, 56 shkolla publike të dëmtuara dhe 15,000 hektarë tokë nën ujë[33].

31 *https://www.gfdrr.org/en*
32 *Post-Disaster Needs Assessment - United Nations in Albania https://albania.un.org/en/46378-albania-post-disaster-needs-assessment-pdna-volume-report-february-2020*
33 *Emergency plan for action, Albania floods, www.lfrc.org*

Si pasojë e ndryshimeve klimatike, pritet që në vitin 2050 temperaturat në Shqipëri të rriten me 2,4°C deri në 3,1°C (USAID 2016)[34] dhe se reshjet do të bëhen më të ndryshueshme. Tendencat historike të temperaturave që nga vitet 1960 kanë treguar se tashmë po përballemi me një rritje të temperaturave mesatare vjetore me 1°C dhe pritet që ky trend të vijojë në rritje (USAID 2016). Ndryshimi i klimës mund të çojë në një rritje të shpeshtësisë dhe ashpërsisë së ngjarjeve të motit ekstrem.

Një studim me të dhëna më të përditësuara është kryer nga qendra e studimeve McKinsey[35] për Mesdheun "Gjiri i Mesdheut pa klimën Mesdhetare", për një grup vendesh ku përfshihet edhe Shqipëria.

Ndërkohë që Mesdheu bëhet më i nxehtë dhe më i thatë, rreziku i mungesave të ujit të pijshëm, zjarreve masive dhe përmbytjeve bregdetare rritet.
Studimi thekson:

Parashikimet klimatike për të nxehtin tregojnë se numri i ditëve me temperaturë maksimale mbi 37°C do të rritet kudo në rajonin e Mesdheut, me një dyfishim në Afrikën Veriore, Spanjën Jugore dhe Turqinë nga 30°C në 60°C deri në vitin 2050.

Thatësira: Në të gjithë vendet, reshjet gjatë sezonit të ngrohtë dhe të thatë nga prilli deri në shtator parashikohet të ulen deri në 10 % brenda vitit 2030, dhe me 20 % deri në vitin 2050. Deri në vitin 2050, kushtet e thatësirës mund të mbizotërojnë për të paktën gjashtë muaj në çdo vit në këto zona. Si rrjedhojë mungesa e ujit do të bëhet më stresuese. Shumë prej baseneve ujore mund të humbasin afërsisht 10 për qind të kapacitetit të tyre për furnizimin me ujë deri në vitin 2030 dhe 25 për qind deri në vitin 2050.

Zjarret: Rritja e niveleve të nxehtësisë e shoqëruar me periudha të gjata të thatësisë parashikohet të shkaktojë zjarre në zona më të mëdha – deri në dyfishin e zonave aktuale në Gadishullin Iberik.

Sëmundjet: Temperaturat e larta të verës janë të lidhura gjithashtu me rritjen e incidencës së etheve të Nilit Perëndimor në Evropë. Vera e vitit 2019 pa rastin e parë të raportuar të infeksionit me virusin e Nilit Perëndimor deri në Gjermaninë veriore. Studiuesit kanë parashikuar tashmë se virusi i Nilit Perëndimor ka të ngjarë të përhapet deri në vitin 2025 me një tendencë në rritje deri në vitin 2050.

Ajo që pritet nga bankat është që këto parashikime të ndryshimeve klimatike t'i çojnë drejt vlerësimeve se çfarë efekti do kishte thatësira e gjatë në portofolin e bankave?

[34] *USAID 2016 https://www.usaid.gov/documents/1867/resilience-usaid-2016-progress-report*

[35] *https://www.mckinsey.com/business-functions/sustainability/our-insights/a-mediterranean-basin-without-a-mediterranean-climate*

Thatësira e gjatë në Shqipëri është e lidhur me performancën e sektorëve të tillë si energjia dhe bujqësia. Prodhimi bujqësor është i varur nga burimet ujore për ujitje. Zvogëlimi i këtyre burimeve do të ulte ndjeshëm kapacitetet hidroenergjetike për prodhimin dhe transmetimin e energjisë. Ndërsa temperaturat e larta ndikojnë në uljen e rendimentit të prodhimeve tipike bujqësore si ato të ullinjve, domateve apo edhe rrushit, prodhime këto të rëndësishme si për konsumin e brendshëm ashtu edhe për eksport, duke sjellë të ardhura më të pakta për popullsinë rurale, e cila e mbështetet mirëqenien e saj kryesisht te të ardhurat e prodhimit bujqësor. Si rrjedhojë, këto ndryshime klimatike do të prekin në mënyrë disproporcionale mirëqenien e kësaj kategorie të popullsisë, pasi ata kanë më pak burime, përfshirë këtu edhe kursimet, dhe shpesh nuk kanë qasje në sistemin financiar.

Sipas studimit të McKinsey për Mesdheun "Gjiri i Mesdheut pa klimën Mesdhetare"[36], ndryshimet klimatike për Rajonin e Mesdheut priten të kenë ndikime të mëdha në turizëm, kontributi i të cilit përben rreth 15% e PBB-së.

Çfarë efekti do kishin ndryshimet strukturale në turizëm për portofolin e bankave?

Në Shqipëri, turizmi veror është i fokusuar kryesisht në plazhe. Deti Adriatik ka përjetuar një rritje mesatare të nivelit të detit prej rreth 15 cm gjatë shekullit të kaluar, duke çuar në një lëvizje tërheqëse të vijës bregdetare për çdo cm të rritjes mesatare të nivelit të detit. Duke i shtuar këtij fenomeni edhe erozionin aktiv detar të shkaktuar nga abuzimi i ndërhyrjeve të njerëzve në menaxhimin e derdhjeve të lumenjve, atëherë mund të themi se çdo vit në Shqipëri zhduken qindra metra katrorë plazhe dhe thahen e shkatërrohen qindra pisha.
Parashikimet mjedisore sugjerojnë se:

- brenda vitit 2030, plazhi i Patokut pritet të zhduket plotësisht, ndërsa plazhet e Kunës dhe Semanit do të mbijetojë vetëm pjesërisht;
- deri në vitin 2050, pjesa më e madhe e plazhit të Kunës dhe Semanit pritet të zhduken.[37]

Studimi për Rajonin e Mesdheut gjen se ndryshimi i klimës nuk ka shkaktuar ende zhvendosjet strukturore në flukset turistike mesdhetare, por shembujt në studim tregojnë se turistët po reagojnë ndaj ndryshimit të klimës. Për shembull, destinacionet e Evropës veriore si Danimarka janë bërë më të kërkuara nga turistët belgë dhe holandezë, të cilët shmangin verën e nxehtë në Evropën Jugore dhe përfitojnë nga verat më të ngrohta në Evropën veriore.

Në Evropën Jugore, valët e të nxehtit mund t'i mbajnë turistët larg plazhit. Kjo ndodhi në Portugali gjatë verës së vitit 2018, kur temperaturat në Lisbonë kaluan 40 gradë dhe lajmet raportonin se temperatura në plazh arrinte deri në 30 gradë celsius që prej orës 8:30 të mëngjesit.

[36] *https://www.mckinsey.com/business-functions/sustainability/our-insights/a-mediterranean-basin-without-a-mediterranean-climate*

[37] *https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2021/10/6.-Komunikimi-i-Tret%C3%AB-Komb%C3%ABtar-i-Republik%C3%ABs-s%C3%AB-Shqip%C3%ABris%C3%AB-drejtuar-Konvent%C3%ABs-Kuad%C3%ABr-t%C3%AB-Kombeve-t%C3%AB-Bashkuara-mbi-Ndryshimet-Klimatike_Qershor-2016.pdf*

Temperaturat parashikohet të vazhdojnë të rriten në të gjithë Evropën Juglindore dhe Shqipëria, gjatë sezonit të verës, pritet të përjetojë temperatura akoma më të nxehta, me një rritje prej 2,4°C në 3,1°C gjatë qershorit deri në gusht. Ndryshimet sezonale të temperaturave për Shqipërinë parashikojnë një zgjatje të sezonit të rritjes me 37 deri në 22 ditë nga veriu në jug.

Rreziqet fizike që vijnë nga këto ndryshime klimatike, sidomos ato të motit ekstrem ndikojnë drejtpërdrejt në ekonomi, duke dëmtuar kështu infrastrukturën publike dhe private, si dhe duke reduktuar vlerat e pasurive dhe produktivitetin. Këto ngjarje mund të ndërpresin aktivitetin prodhues dhe tregtar, duke krijuar një mungesë të theksuar burimesh. Rikuperimi kërkon përdorim më të madh kapitalesh për rindërtimin dhe zëvendësimin e burimeve të nevojshme. Si rrjedhim, çdo dëm i shkaktuar mund të kthehet në një rrezik financiar për bankat, nëse ato janë të ekspozuara ndaj tij.

Efektet "spillover" dhe lidhjet ndërmjet sistemit bankar dhe makroekonomisë mund t'i përkeqësojnë edhe më tej këto ndikime dhe rreziqe. Për shembull, dëmtimi i aktiveve që shërbejnë si kolateral mund të krijojë humbje për bankat që përkthehen në kufizime për kreditimin në rajone të caktuara, duke reduktuar kështu financimin e domosdoshëm për rindërtimin e zonave të prekura. Në të njëjtën kohë, këto humbje dobësojnë pasurinë e familjes dhe mund të kthehen në një konsum të reduktuar.

Bankat duhet të kenë një hartë të sektorëve vulnerabël ndaj ndryshimeve klimatike, si për rreziqet fizike ashtu edhe për rreziqet e tranzicionit. Harta e rreziqeve fizike duhet të tregojë ekspozimin e firmave të kredituar nga banka sipas gjeografisë së firmës dhe kolateralit në vendet e rrezikuara më shumë nga përmbytjet, zjarret apo tërmetet. Bankat duhet të identifikojnë ekspozimet e portofolit të tyre ndaj rreziqeve fizike, të cilat kanë më shumë gjasa të ndodhin në Shqipëri, me qëllim matjen e vulnerabilitetit dhe adaptimin e politikave përkatëse ndaj humbjeve të mundshme.

RREZIQET E TRANZICIONIT TË KLIMËS DHE NEVOJA E NJË HARTE TË EKSPOZIMEVE FINANCIARE TË RREZIQEVE TË KLIMËS

Rreziqet e tranzicionit lidhen me procesin e përshtatjes drejt një ekonomie me emision të ulët. Procesi i reduktimit të emetimeve ka të ngjarë të ketë ndikime të konsiderueshme në të gjithë sektorët e ekonomisë, duke ndikuar financiarisht në vlerat e aseteve. Ndërkohë që masat e ndërmarra për zvogëlimin e emisionit janë mëse të nevojshme, një ndalim i sforcuar ligjor i aktivitetit do të sillte një tranzicion të papritur dhe mund të ndikonte në stabilitetin financiar të një sektori të caktuar si dhe ekonominë në tërësi. Në këtë kontekst, shkalla e transformimit ekonomik, strukturor dhe financiar e këtij tranzicioni është shumë domethënëse, duke sjellë njëkohësisht si rreziqe dhe mundësi për sistemin bankar dhe sektorët realë të ekonomisë.

Të dhënat më të fundit zyrtare për Shqipërinë, të analizuara për të kuptuar emisionin e gazeve serë, janë të vitit 2009. Në deklaratën e qeverisë ku përfshihen dhe angazhimet e ndërmarra për adaptimin dhe minimizimin

e rreziqeve nga ndryshimet klimatike janë matur dhe vlerësuar emetimet e drejtpërdrejta të gazeve serë (GHG)[38] si dhe emetimet indirekte.

Kontribuuesi kryesor i emetimit të drejtpërdrejtë të GHG është sektori i energjisë që përfaqëson 52,28% e totalit, e ndjekur nga bujqësia (15,83%), industria (12,61%), përdorimi i tokës dhe pyjet (11,91%) dhe mbetjet (7,37%). Është e rëndësishme të përmendet se emetimet në sektorin e përdorimit të tokës dhe pyjet kanë pësuar rënie të ndjeshme gjatë viteve 2008 - 2009, ndërkohë që sektori i proceseve industriale po rrit emetimet e tij.

Emetimet e CO2 nga sektori i energjisë përbëjnë 97,07% të emetimeve të përgjithshme në 2005.

Nënsektori i transportit kontribuoi me 45.06% të emetimeve të përgjithshme të CO2 në 2005, dhe transportit rrugor përbën tashmë kontribuuesin kryesor në këtë fushë.

EMETIMET INDIREKTE TË GHG (GG)

Rreth 94.65% e gazeve CH4 emetohen nga sektori i blegtorisë gjatë fermentimit enterik dhe menaxhimit të plehut organik.

Emetimet e N2O vijnë kryesisht nga aplikimi i plehrave nitrike. Emetimet e CH4 dhe N2O si rezultat i djegies së mbetjeve bujqësore janë të parëndësishme. Aktivitetet bujqësore, si kultivimi i të lashtave dhe blegtoria për ushqim, kontribuojnë në rritjen e këtyre emetimeve. Ka një sërë aktivitetesh të cilat mund të kontribuojnë në emetimet e N2O nga tokat bujqësore, dhe që variojnë nga aplikimi i plehrave deri te metodat e ujitjes dhe punimit të tokës.

Në mungesë të të dhënave më të fundit zyrtare për Shqipërinë për të kuptuar tendencat dhe emetimin sipas sektorëve, po i referohemi të dhënave nga BE-ja. Studimi i Mckinsey & company "The net-zero transition what it would cost and what it could bring"[39] përshkruan qartë dhe me detaje sektorët kryesor të cilët kërkojnë adaptim dhe ristrukturim, me qëllim uljen e emisionit.

[38] *Përkufizimi ne anglisht: https://www.britannica.com/science/greenhouse-gas "greenhouse gas, any gas that has the property of absorbing infrared radiation (net heat energy) emitted from Earth's surface and reradiating it back to Earth's surface, thus contributing to the greenhouse effect. Carbon dioxide, methane, and water vapour are most important greenhouse gases".*

[39] *https://www.mckinsey.com/business-functions/sustainability/our-insights/the-net-zero-transition-what-it-would-cost-what-it-could-bring fq 10.*

Tabela e mëposhtme vjen nga studimi i Mckinsey & company "The net-zero transition what it would cost and what it could bring".

Përqindjet e emisionit të Co2, 2019, %						
CO2 emision	Energjia	Industria	Transporti	Ndërtesa	Bujqësia	Pyjet
	30	30	19	6	1	14

Përqindjet sipas nënsektorëve, %						
Co2 emision, 2019	Energjia	Industria	Transporti	Ndërtesat	Bujqësia	Pyjet
	Elektriciteti 97	Celiku 26	Rrugor 75	Rezidenciale 70	Fermat 96	Pyjet 100
	Ngrohja 3	Cimento 20	Ajror 13	Komerciale 30	Peshkimi 4	
		Nxjerrja e naftës dhe gazit 15	Detar 11			
			Hekurudhor 1			
		Kimike 12				
		Minierat 6				
		Të tjera 20				

CH4 Methane emisionne %	Industri	Bujqësi	Pyjet	Mbetjet
	33	38	5	23

N20 Nitrous oxide emmision %	Bujqësia	Industria	Energjia	Pyjet	Mbetjet	Transporti
	79	8	3	5	3	2

Burimi: Të dhënat e BE sipas studimit te Mckinsey & company "the-net-zero-transition-what-it-would-cost-and-what-it-could-bring" faqe 10 .

Të dhënat e mësipërme na tregojnë se energjia dhe industria janë sektorët kryesorë të emetimit të CO2 dhe së bashku këto sektorë gjenerojnë 60% të emisioneve të CO2.

Fokusi i menaxhimit të rreziqeve të tranzicionit siç na tregojnë të dhënat e vitit 2019 është:

- adaptimi i sektorëve të energjisë që kontribuon me 30% të emetimit të CO2 në BE (energji elektrike dhe ngrohje);
- adaptimi i industrisë dhe nënsektorëve me emetim të lartë (industrisë përpunuese kryesisht prodhimi i çimentos, prodhimi i çelikut, i kimikateve si dhe industria nxjerrëse);
- adaptimi i sektorit të transportit që kontribuon me 19% të emetimit të CO2 dhe kryesisht transportit rrugor, i cili gjeneron 75% të emetimit të sektorit;
- adaptimi i sektorit të bujqësisë me qëllim reduktimin e emetimit të gazit metan (CH4) dhe oksid azoti (N2O), për të cilët ky sektorë është gjeneruesi kryesor.

Në përputhje me projektin e BE-së për Ballkanin Perëndimor (instrumenti i paraaderimit), një ndër sektorët për të cilin kërkohet ristrukturim është sektori i ndërtimit. Ky sektor vlerësohet që konsumon mbi 40% të konsumit total të

energjisë në Ballkanin Perëndimor. Rinovimi i ndërtesave publike dhe private për të përmbushur standardet e performancën minimale të energjisë mund të japë një kontribut shumë të rëndësishëm në reduktimin e emetimit të gazeve serë. Për këtë arsye, Komisioni Evropian ka zgjeruar planin "EU renovation wave"[40] dukë përfshirë këtu edhe Ballkanin Perëndimor.

PLANET DHE POLITIKAT NË ZBATIM TË AGJENDËS MJEDISORE

Në zbatim të angazhimit të Marrëveshjes së Parisit, në kuadër të procesit të tranzicionit, Shqipëria do të duhet të përshtasë kuadrin e saj ligjor për të gjithë sektorët me emetim të lartë. Në këtë kontekst, si një prej palëve kontraktuese të "Traktatit të Komunitetit të Energjisë", Shqipëria duhet të përafrojë Direktivën e BE-së 2009/28/EC "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme". Në kuadër të harmonizimit të kësaj direktive, përmes VKM-së nr.27, datë 20.1.2016, qeveria miratoi "Planin Kombëtar të Energjisë së Rinovueshme". Në Plan përcaktohet si një objektiv kombëtar i detyrueshëm që: "38% e konsumit përfundimtar të energjisë së vendit të realizohet përmes burimeve të rinovueshme".

Plani, ndër të tjera, përcakton edhe masat mbështetëse për arritjen e objektivave të politikave të mëposhtme në lidhje me:

i. reduktimin e importit të energjisë elektrike;
ii. diversifikimin e burimeve primare të energjisë për furnizimin me energji elektrike;
iii. zvogëlimin e humbjeve në transmetim dhe shpërndarje;
iv. krijimin e bizneseve lokale dhe mundësive të punësimit, duke instaluar dhe prodhuar pjesë/përbërës/sisteme të impianteve të BRE sipas sektorit industrial shqiptar;
v. shfrytëzimin e burimeve lokale të energjisë veçanërisht në zonat e thella, me qëllim hapjen e vendeve të reja të punës dhe përmirësimit të standardit të jetës.

Për sektorë të tjerë të ekonomisë, agjenda e dekarbonizimit të ekonomisë shqiptare tashmë është pjesë e proceseve integruese në Bashkimin Evropian dhe si e tillë është nën mbikëqyrjen e BE-së.

[40] *https://www.eesc.europa.eu/en/news-media/press-releases/integrating-western-balkan-partners-eu-represents-geostrategic-investment-peace-says-eesc*

Në tetor 2020, BE-ja ka ngritur një mekanizëm të tranzicionit "Green Deal for the Western Balkans"[41] për të ndihmuar dhe financuar koston e tranzicionit drejt një ekonomie me emision karboni të ulët. Ky instrument përpiqet të adresojë pesë shtylla kryesore si më poshtë:

(1) veprimin ndaj klimës, përfshirë këtu dekarbonizimin, energjinë dhe transportin;
(2) ngritjen e një ekonomie rrethore (cikël i mbyllur), duke trajtuar në veçanti mbetjet, riciklimin, prodhimin e qëndrueshëm dhe përdorimin efikas të burimeve;
(3) biodiversitetin, duke synuar mbrojtjen dhe restaurimin e pasurisë natyrore të rajonit;
(4) luftën kundër ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës; dhe
(5) ndërtimin e sistemeve të qëndrueshme ushqimore në zonat rurale.

Në këtë dokument specifikohet se: "Prodhimi i ushqimit bazë dhe përpunimi, së bashku me peshkimin dhe pyjet, zënë një peshë të konsiderueshme të PBB-së të Shqipërisë. Ky sektor punëson 40% të të gjithë të punësuarve dhe ka një potencial të madh për zhvillim ekonomik dhe të qëndrueshëm.[42]

Referuar këtij plani investimi, objektivi i BE-së është që: "Së bashku me institucionet financiare, të mbështesë vendet e Ballkanit Perëndimor në drejtim të trefishimit të ritmit aktual të rinovimit dhe kursimit të energjisë së ndërtesave ekzistuese për të arritur një emision pothuajse zero në ndërtesat e reja".

Disa prej objektiva të tjerë të shprehur në këtë plan janë: "Rritja e shumës së grantit për të mbështetur sektorin privat në kuadër të investimeve në Ballkanin Perëndimor. Në këtë kontekst, rreth 50% e financimit të sektorit privat nga fondet e BE-së duhet t'i kushtohet inovacionit dhe rritjes së gjelbër".[43]

Implementimi i kësaj agjende kërkon transformim drastik të ekonomisë sonë – duke filluar nga mënyra e prodhimit të ushqimeve, prodhimi i energjisë, transporti dhe infrastruktura – dhe zëvendësimin e teknologjisë së vjetër me alternativa teknologjike me emetim të ulët. Ky transformim është i shoqëruar me kosto të lartë në shumë sektorë dhe kërkon vendosmëri në zbatimin e kuadrit ligjor si dhe financime të tjera përveç instrumentit të paraaderimit të ngritur nga BE (WBIF Projects).

Është e qartë për të gjithë se pa financimin e duhur arritja e "net-zero emision" duket e pamundur, ndaj dhe aktorët më të fuqishëm financiarë dhe bankarë në botë janë bashkuar në aleancën më të fundit (Net-Zero Banking Alliance)[44] me angazhimin e tyre edhe për "net-zero banking", duke dekarbonizuar portofolet e tyre dhe fokusuar drejt kreditimit të gjelbër. Ka ardhur koha që edhe sistemi

[41] *https://www.eesc.europa.eu/en/news-media/press-releases/integrating-western-balkan-partners-eu-represents-geostrategic-investment-peace-says-eesc*
[42] *https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2020-10/communication_on_wb_economic_and_investment_plan_october_2020_en.pdf*
[43] *https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2020-10/communication_on_wb_economic_and_investment_plan_october_2020_en.pdf. fq 27*
[44] *https://www.unepfi.org/net-zero-banking/*

bankar shqiptar të ndërmarrë rolin përkatës për të nxitur ekonominë e gjelbër dhe kontribuuar në një mjedis të sigurt.

HARMONIZIMI I AGJENDËS MJEDISORE LOKALE DHE RAJONALE NË STRATEGJITË DHE PLANET E BANKAVE

Ndërkohë që vetë bankat kanë emetime të ulëta, ndikimi i tyre në klimë vjen kryesisht nga bizneset e projektet që ato financojnë apo investojnë. Struktura e portofoleve të bankave shpesh reflekton edhe strukturën më të plotë të ekonomive ku ato operojnë. Harmonizimi i kapitalit të bankave me kërkesat për objektivin drejt 1.5°C i detyron bankat të analizojnë dhe shohin portofolet e tyre nën gjithë këndvështrimet e duhura sipas rreziqeve klimatike me të cilat mund të përballen. Duke filluar me ekspozimin në të gjithë sektorët me emetime të larta, në të gjitha zonat gjeografike dhe për të gjitha kategoritë e aktiveve.

Njohja e situatës në çdo sektor dhe konsultimi me politikat dhe strategjitë përkatëse do të bëjë të mundur krijimin e një harte veprimesh, e cila do të orientojë dhe sektorin bankar drejt mundësive ku kërkohet ristrukturim apo edhe investim në inovacione teknologjike sipas agjendës mjedisore.

HARTIMI I KUADRIT PËR MENAXHIMIN E RREZIQEVE TË KLIMËS

Administrimi i rreziqeve të klimës nuk është vetëm një proces që duhet të mbrojë një bankë nga humbjet e ardhshme, por duhet të fillojë me identifikimin dhe matjen e rreziqeve të klimës në portofolin ekzistues. Bankat duhet të fillojnë të skanojnë dhe filtrojnë ato ekspozime ku rreziqet fizike të përmendura më sipër, nga ndryshimet klimatike, mund t'i shkaktojnë humbje.

Hapi i parë në drejtim të ngritjes së kuadrit për menaxhimin e rreziqeve të klimës duhet të jetë administrimi i rreziqeve fizike në portofolin aktual të bankës. Skanimi dhe identifikimi duhet të kryhet për çdo sektor, sipas pozicionimi gjeografik dhe vendndodhjes së kolateraleve dhe për çdo kategori asetesh.

Një shembull skanimi sipas sektorëve dhe qarqeve është edhe skeda e mëposhtme:

	BANKA ABC				Dega Qarku Shkodër	
	Rreziku i Klimës		Data :			
		Lista e Ekspozimeve të Kredive ndaj Rrezikut të klimës				
		Përmbytjet				
	Lista e kredive në sektorin bujqësor					
Nr	Subjekti	Qëllimi	Maturiteti	Shuma	Vendodhja	Kolaterali
1	Shiroka	Blerja e Barke peshkimi				
2	Sera	Mbjellja e pemëve frutore				
3						
4						
Masat Mitiguese					Humbja nëse ndodh	
Nr						
1	Ofrimi i një linje kredie për ndërtimin e një moli të ri dhe blerjen e një frigoriferi magazinues të sigurt nga përmbytja				Shpenzimi	Vlera (lekë)
					TOTALI	
2	Ofrimi i një discounti për shlyerjen e menjëhershme të kredisë				Shpenzimi	Vlera (lekë)
					TOTALI	
	Vlera parashikuar e humbjes nëse ndodh rreziku			Ekspozimi nga masat mitiguese		
	Komente të tjera nga Drejtuesi i Degës					
		Përgatiti (Nëpunësi)				
		Emër	Mbiemër	Firmë		

Burimi: Krijuar nga autorja.

Me qëllimin mbrojtjen e portofolit të bankave nga pasiguritë e rreziqeve të ndryshimit të klimës si dhe dekarbonizimin e kreditimit të tyre, filtrimi dhe skanimi i mësipërm duhet bërë për të gjithë rreziqet fizike që shkenca e klimës parashikon të ndodhin në vendin tonë si p.sh:

Përmbytjet në veri të vendit

Sa ekspozim ka banka në bujqësi, ndërtim, infrastrukturë sipas shpërndarjes gjeografike? Sa nga këto rreziqe fizike të cilat lidhen me përmbytjet do të transmetohen në rreziqe financiare? Në cilat biznese dhe në cilët sektorë është ekspozimi i bankës? Çfarë masash mund t'i minimizojnë humbjet?

Thatësira e zgjatur

Sa ekspozim ka banka ndaj prodhimit të energjisë nga hidrocentralet? Sa ekspozim ka banka në jug të vendit dhe si mund të mbrohet ajo nga rreziku i zjarreve gjatë verës?

Hapi i dytë i rëndësishëm në hartimin e kuadrit të menaxhimit të rreziqeve të klimës është administrimi i rreziqeve të tranzicionit. Këto rreziqe transmetohen në rreziqe financiare për bankën dhe vijnë kryesisht nga:

- ndryshimet e politikave të klimës ndaj një sektori specifik të ekonomisë;
- detyrimet ligjore në zbatim të traktateve të klimës dhe energjisë për reduktimin e emisioneve të larta;
- ndryshimet teknologjike të nevojshme për mjedisin e sigurt;
- ndryshimet strukturore dhe reformimeve të tregut (nga ndryshimi i kërkesave të konsumatorëve si prej ndryshimeve të çmimeve prej "taksave të karbonit" apo dhe nxitjeve për mbrojtjen e ekosistemeve natyrore dhe drejt një mjedisi të sigurt).

Për çdo sektor (të përmendur më sipër) ku kërkohet reduktimi i emisionit, banka duhet të filtrojë ekspozimin e saj, duke iu përgjigjur pyetjeve të mëposhtme:

Sa ekspozim ka banka në sektorin e energjisë jo të rinovueshme (termocentrale apo hidrocentrale)? Objektivi i qeverisë është: 38% e konsumit përfundimtar të energjisë totale të vendit të vijë nga burime të rinovueshme. Si po e harmonizon banka politikën e kreditimit drejt oportunitetit për investime të domosdoshme në energjinë e rinovueshme?

Sa ekspozim ka banka në industrinë e prodhimit të çimentos dhe të inerteve? Cili është plani i bankës për zhvendosjen graduale të këtij ekspozimi drejt industrive me net-zero emision, si një prej objektivave të politikës mjedisore? Sa ekspozim ka banka në industrinë agro-ushqimore dhe sa nga këto biznese kanë certifikata të standardit të cilësisë?

Sa ekspozim ka banka ndaj industrisë së transportit dhe shitjes së makinave joelektrike?

Sa ekspozim ka banka në sektorin e pasurive të patundshme: sa nga ndërtesat e financuara kanë ngrohjen e certifikuar sipas standardeve mjedisore?

Sa ekspozim ka kundrejt biznesit të ngrohjes dhe ftohjes? (kërkesa për kondicioner elektrik pa certifikatën e ngrohjes standarde është në ulje dhe kufizimi i këtij aktiviteti po bëhet sipas politikave përkatëse).

Sa ekspozim ka banka në sektorin e turizmit? Në cilat plazhe është ekspozimi më i madh dhe sa afatgjatë është ai? Si do të ndikojë në planet e amortizimit të kredive parashikimi për ndryshime të sezonit?

Për të gjithë sektorët, në strategjitë kombëtare dhe planet e veprimit për zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike, kërkohet ngritja e fondeve si në nivel rajonal dhe vendor. Bankat mund ta shikojnë menaxhimin e rreziqeve nga tranzicioni edhe si një mundësi për bashkëpunim dhe kanalizimin e fondeve dhe granteve ndërkombëtare të ngritura nga kërkesat e planeve të veprimit në çdo sektorë ku ndërhyrja është urgjente.

Disa prej instrumenteve financiare për të cilat janë krijuar edhe fondet përkatëse që synojnë të realizojnë ristrukturimin e sektorëve me emetim të lartë dhe rigjenerimin e ekosisteme natyrore. Një prej tyre është edhe instrumenti i paraaderimit të BE-së me një vlerë totale 9 miliardë euro, të cilat janë planifikuar për investime në sektorët e mësipërm (energji, transport, agro-ushqimore dhe ekonomi e ciklit te mbyllur)[45]. Përmes këtij instrumenti, BE-ja e ka përcaktuar qartësisht se do të financojë rreth 50% të fondeve në "projektet e gjelbëra" dhe inovacionin dhe se këtë proces do ta kryejnë së bashku me institucionet financiare.

Instrumente të tillë qëndrojnë pas aleancave dhe grupeve financiare të fokusuara te mjedisi si: "Global Environment Facility (GEF)[46], i cili mbledh nga ana e tij fonde për të financuar programe në mbrojtje të biodiversitetit. Në bashkëpunim me këto instrumente si dhe grantet ndërkombëtare të ngritura nga projektet e sektorëve specifikë, bankat mund të krijojnë sinergji dhe, nëpërmjet "syndicated loan" dhe garancive shtetërore, të financojnë projekte të guximshme për dekarbonizimin e industrive që nga ato të çimentos deri te prodhimet e serave, duke realizuar kështu njëkohësisht dy objektiva: i) minimizimin e ekspozimeve të portofoleve të tyre nga rreziqet e tranzicionit si dhe ii) reduktimin e emisioneve të larta.

Hapi i tretë për hartimin e kuadrit të menaxhimit të rreziqeve të klimës është rishikimi në dy drejtime: 1) rishikimi i strategjisë së kreditimit dhe –2) rishikimi i procesit të vendimmarrjes për kreditim, me synim integrimin në procesin e aprovimit të kreditimit edhe të vlerësimit mjedisor për çdo kreditim të ardhshëm.

1) Rishikimi i strategjisë nënkupton që banka në planet e veta të biznesit duhet të shpallë qartë kufizimet graduale të kreditimit për sektorë me ekspozim ndaj rrezikut të mjedisit, si dhe duke ofruar plane ristrukturimi për ato sektorë që janë në procesin e tranzicionit. Gjithashtu, banka duhet të komunikojë dhe publikojë qartësisht që nuk do të mundësojë financime ndaj bizneseve, aktivitetet e të cilave mund të degradojnë ekosistemet natyrale. Në publikimin dhe transparencën e përgjegjshmërisë mjedisore, bankat jo vetëm që shmangin rrezikun e tyre reputacional, por edhe tregojnë vullnetin përkatës në zbatim të parimeve të përgjegjshmërisë bankare. Në strategjitë e tyre duhet të planifikohet, ndër të tjera, edhe shpërndarja e burimeve drejt tregjeve të reja të teknologjisë së mjedisit të sigurt, si energjia e rinovueshme, ndërtimi i impianteve të erës apo paneleve diellore dhe industria e riciklimit dhe pastrimit.
2) Rishikimi i procesit të vendimmarrjes për kreditim nënkupton që në procesin e skanimit të klientit duhen marrë në konsideratë vlerësimet mjedisore në nivel makro (sektori, industrie) dhe në nivel mikro (biznesi dhe rrjeti).

Në nivelin makro duhet marrë në konsideratë fakti nëse sektori i cili kërkon të kreditohet përfshihet te sektorët me përparësi dhe nëse ky sektor mbështetet nga planet mjedisore të qeverisë shqiptare, të komunitetit evropian dhe mbështetjes

[45] *https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2020-10/communication_on_wb_economic_and_investment_plan_october_2020_en.pdf*
[46] *https://fiftrustee.worldbank.org/en/about/unit/dfi/fiftrustee/fund-detail/gef*

ndërkombëtare. Investimi mund të aprovohet edhe nëse industria është në proces tranzitimi, kur provohet se masat dhe veprimet e ndërmarra nga biznesi kanë zbutur ndikimet në mjedis dhe ky investim kontribuon pozitivisht në minimizimin e mëtejshëm.

Njëkohësisht, do të merret në konsideratë nëse projekti është mjaftueshëm i gjelbër për të mundësuar kthimin e tij në një financimin të gjelbër me avantazhin për kanalizimin e fondeve të tjera nga grantet e projekteve të gjelbër. Raporti i grupit të pavarur të eksperteve të "Global Financial Stability Report No. 2020/001"[47] ka vlerësuar se janë gati për t'u shpërndarë si financa për klimën 100 miliardë dollarë".

Në nivelin mikro, vlerësimi duhet kaluar në objektin e biznesit apo pronës nëse emetimet direkte të biznesit janë në përputhje me standardet e sigurisë mjedisore. Në këtë kontekst, duhet marrë në konsideratë nëse lëndët e para dhe proceset e prodhimit dhe përpunimit, ashtu si edhe produkti përfundimtar, janë brenda standardeve të certifikuara mjedisore.

Ajo që kërkohet nga sektori bankar është që të integrojë në praktikat e tij bankare standardet e përgjegjshmërisë sociale dhe qëndrueshmërisë mjedisore (ESMR). Parimet për përgjegjshmërinë bankare (Principles for Responsible Banking PRB)[48] u prezantuan në vitin 2019 dhe janë të integruara tashmë nga 1/3 e sektorit bankar global, së bashku me parimet e investimeve të përgjegjshme (Principles for Responsible Investment). Shumë institucione financiare globale dhe zhvillimore si Banka Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillimi, IFC dhe Fondi i Gjelbër i Klimës (Green Climate Fund) dhe shumë donatorë të tjerë kanë miratuar dhe integruar në praktikat e tyre të financimit të projekteve, parimet që referohen si menaxhimi i rreziqeve mjedisore dhe sociale (Environmental and social risk management (ESRM)). Integrimi i këtyre parimeve dhe standardeve do e vinte sektorin bankar në pozitë favorizuese, duke i mundësuar atij oportunitetin për të kanalizuar më shumë fonde të orientuara drejt agjendës mjedisore, si asaj lokale ashtu dhe rajonale. Po kështu kërkohet dhe transparenca e të dhënave financiare të lidhura me klimën. Bordi i Stabilitet Financiar ka përcaktuar dhe standardet e transparencës.[49]

Këto korniza normative edhe pse jozyrtare, ofrojnë bazën për vendosjen e standardeve për financimin e qëndrueshëm, duke ndihmuar për të siguruar që financat private të përmbushin rolin e tyre për të kontribuuar në arritjen e Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Marrëveshjes së Parisit për Ndryshimet Klimatike të dakordësuar nga qeveritë në mbarë botën në vitin 2015.

---

[47] *IMF. 2020a. "Global Financial Stability Report No. 2020/001." Independent Experts Group on Climate Finance. 2020. "Delivering on the $100 Billion Climate Finance Commitment and Transforming Climate Finance."*

[48] *https://www.unepfi.org/banking/bankingprinciples/*

[49] *The Financial Stability Board's Task-Force on Climate-related Financial Disclosures Disclosures (TCFD) https://www.fsb-tcfd.org/ Task Force on Climate-related Financial Disclosures.*

VLERËSIME PËRFUNDIMTARE

Mbase modelet ekonomike nuk munden ende të vlerësojnë saktësisht efektin përkatës apo dhe të parashikojnë saktë kostot që do vijnë në ekonomi nga rreziqet e ndryshimeve klimatike, por shkenca e klimës dhe vlerësimet e saj e kanë bërë të qartë, pa asnjë mëdyshje, se nëse nuk veprohet tani efektet e tyre mbi ekzistencën e jetesës në planet do të jenë të paripërueshme.

Tashmë ka ardhur koha për të ndërmarrë veprime të rëndësishme. Nëse duam të kemi një planet të sigurt kërkohet një bashkëveprim i të gjithë aktoreve që nga organizatat ndërkombëtare deri te qeveritë e institucionet bankare, përfshirë këtu edhe bizneset e individët. Të bindur se pa kontributin e financimeve nuk ka rezultate ndaj emergjencës klimatike, shumë institucione financiare janë mobilizuar nëpërmjet aleancave dhe angazhimeve të kanalizojnë vëmendjen dhe financimet e tyre drejt këtyre ndryshimeve klimatike.[50]

Është e nevojshme që edhe sistemi bankar shqiptar të ndjekë ritmin e ndryshimeve që po kërkohen, fillimisht duke ngritur strukturën për njohjen dhe integrimin e rreziqeve të klimës në proceset e tyre të menaxhimit të rreziqeve, me qëllim mbrojtjen e portofolave të bankave dhe, së dyti, duke riformuluar strategjitë e kreditimit dhe orientuar kapitalin dhe ekspertizën drejt kreditimit të gjelbër.

Këto zhvillime duhet të integrohen në veprimtarinë e përditshme të bankave, me qëllim ngritjen e kapaciteteve te tyre për të menaxhuar rreziqet e klimës (si ato aktuale edhe ato të ardhshme), por njëkohësisht të jenë në gjendje të përdorin avantazhet e këtij momenti ku shumë financa globale po orientohen drejt investimeve të gjelbra. Përshtatja e parimeve të përgjegjshmërisë ndaj mjedisit social dhe qëndrueshmërisë mjedisore (ESMR), që shumë institucione globale financiare (IFC, WB etj.) kanë adoptuar, dhe përfshirja e transparencës ndaj klimës, kanë rëndësi të trefishtë për sistemin bankar:

- së pari, ajo i ruan bankat nga rreziku reputacional, si dhe ruan portofolet e tyre nga rreziqet klimatike;
- së dyti, kjo përshtatje me parimet e përgjegjshmërisë ndaj klimës i bën bankat e sistemit bankar të pranueshme për të kanalizuar financimet globale të ngritura për klimën; dhe
- së treti, u mundëson bankave njohjen e oportuniteteve dhe inovacioneve dhe bashkëfinancimin e investimeve fitimprurëse dhe me impakt në rritjen e gjelbër dhe të qëndrueshme të ekonomisë shqiptare.

[50] *The Coalition of Finance Ministers for Climate Actions. 2020. "Better Recovery, Better World: Resetting Climate Action in the Aftermath of the COVID-19 Pandemic."*

LITERATURA:

Climate Action Tracker 2020."CAT Emissions Gaps." September2020. https://climateactiontracker.org/global/cat-emissions-gaps/

Summary for policymakers," in Climate change 2021: The physical science basis: Contribution of Working Group I to the Sixth Assessment Report, IPCC, 2021.7

Climate Risk Country Profile: Albania
https://climateknowledgeportal.worldbank.org/sites/default/files/2021-06/15812-Albania%20Country%20Profile-WEB.pdf

Carney 2015 "Breaking the tragedy of the horizon Climate change and financial stability "https://www.bankofengland.co.uk/speech/2015/breaking-the-tragedy-of-the-horizon-climate-change-and-financial-stability

C. Herweijer et al. (2020), Nature Risk Rising: Why the Crisis Engulfing Nature Matters for Business and the Economy, World Economic Forum, http://www3.weforum.org/docs/WEF_New_Nature_Economy_Report_2020.pdf

GFDRR (2020). Disaster Risk Finance Diagnostic – Albania. December 2020. https://www.financialprotectionforum.org/publication/disaster-risk-finance-diagnostic-albania.

UNFCCC. 2020. "Paris Agreement." United Nations Framework Convention on Climate Change. Accessed March 10, 2020. https://unfccc.int/process-and-meetings/the-paris-agreement/the-paris-agreement

Marrëveshja e Parisit 2015; Lista e përditësuar e "Aleancës së Ambicieve Klimatike: Net-Zero 2050" mund të gjendet në https://climateaction.unfccc.int/views/cooperative-initiative-details.html?id=94

DeFries, R., O. Edenhofer, et al (2019): The Missing Economic Risks in Assessments of Climate Change Impacts. Grantham Research Institute on Climate Change and the Environment.

Emergency plan for action, Albania floods, www.Ifrc.org
https://www.unepfi.org/banking/bankingprinciples/

Helmholtz Association of German Research Centres (2008, September 15), Economic Value of Insect Pollination Worldwide Estimated at U.S. $217 Billion. ScienceDaily. Retrieved March 1, 2011, from http://www.sciencedaily.com/releases/2008/09/080915122725.htm

D. J. Newman and G. M. Cragg (2012), "Natural products as sources of new drugs over the 30 years from 1981 to 2010.

IMF. 2020a. "Global Financial Stability Report No. 2020/001." Independent Experts Group on Climate Finance. 2020. "Delivering on the $100 Billion Climate Finance Commitment and Transforming Climate Finance."

McKinsey & Company, December 2020. "How the European Union could achieve net-zero emissions at net-zero cost."

McKinsey & Company "The net-zero transition what it would cost and what it could bring." https://www.mckinsey.com/business-functions/sustainability/our-insights/the-net-zero-transition-what-it-would-cost-what-it-could-bring.

McKinsey & Company "A Mediterranean basin without a Mediterranean climate? Case study May 2020 https://www.mckinsey.com/business-functions/sustainability/our-insights/a-mediterranean-basin-without-a-mediterranean-climate.

Lenton, Timothy M., Johan Rockström, Owen Gaffney, Stefan Rahmstorf, Katherine Richardson, Will Steffen, and Hans Joachim Schnellhuber. 2019. "Climate Tipping Points — Too Risky to Bet Against." Nature 575: 592-595.

Third National Communication of the Republic of Albania under the United Nations Framework Convention on Climate Change. URL:

- *https://unfccc.int/sites/default/files/resource/Albania%20NC3_13%20October%202016.pdf*
- *https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2021/10/6.-Komunikimi-i-Tret%C3%AB-Komb%C3%ABtar-i-Republik%C3%ABs-s%C3%AB-Shqip%C3%ABris%C3%AB-drejtuar-Konvent%C3%ABs-Kuad%C3%ABr-t%C3%AB-Kombeve-t%C3%AB-Bashkuara-mbi-Ndryshimet-Klimatike_Qershor-2016.pdf.*

The Coalition of Finance Ministers for Climate Actions. 2020. "Better Recovery, Better World: Resetting Climate Action in the Aftermath of the COVID-19 Pandemic".

The Financial Stability Board's Task-Force on Climate-related Financial Disclosures (TCFD) https://www.fsb-tcfd.org/ Task Force on Climate-related Financial Disclosures.

"Scaling up Green Finance: The Role of Central Bank NGFS (2018), https://www.ngfs.net/sites/default/files/media/2019/10/02/call_for_papers__scaling_up_green_finance_0.pdf.

Sejko G (2022) Banka qendrore dhe politikat e saj ne kohen e Covid-19 Sfidat për te ardhmen https://www.bankofalbania.org/Botime/Botime_te_vecanta/Banka_qendrore_dhe_politikat_e_saj_ne_kohen_e_Covid-19_Sfidat_per_te_ardhmen.html.

Integrating the Western Balkan partners in the EU represents a geostrategic investment in peace, says the EESC, EU.

- *https://www.eesc.europa.eu/en/news-media/press-releases/integrating-western-balkan-partners-eu-represents-geostrategic-investment-peace-says-eesc*
- *https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2020-10/communication_on_wb_economic_and_investment_plan_october_2020_en.pdf*
- *https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2020-10/communication_on_wb_economic_and_investment_plan_october_2020_en.pdf*

World Bank. 2020. "Reversals of Fortune." Poverty and Shared Prosperity report, Washington D.C.

World Ocean Review. 2020. Fisheries. Accessed April 10, 2020. https://worldoceanreview.com/en/wor-1/fisheries/fisheries-management/.